Pa cenuar nënparagrafin e katërt, një shtet anëtar gjithashtu mund në çdo kohë të vendosë të modifikojë apo revokojë vendimin e mëhershëm të referuar në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi. Në raste të tilla, informon pa vonesë Komisionin dhe agjencinë për këtë.	Without prejudice to the fourth subparagraph, a Member State may also at any time decide to modify or revoke the earlier decision referred to in the first subparagraph of this paragraph. In such cases, it shall without delay inform the Commission and the Agency thereof.	Ne dovodeći u pitanje četvrti podstav, država članica može u svakom trenutku odlučiti da izmeni ili ukine svoju raniju odluku iz prvog podstava ovog stava. U takvim slučajevima ona o tome bez odlaganja obaveštava Komisiju i Agenciju.
Agjencia përfshinë në repozitorin (bazën e të dhënave) e referuar në nenin 74 të gjitha vendimet e Komisionit dhe të shteteve anëtare të cilat janë njoftuar sipas këtij paragrafi.	The Agency shall include in the repository referred to in Article 74 all of the decisions of the Commission and of the Member States that have been notified pursuant to this paragraph.	Agencija u bazu podataka iz člana 74. unosi sve odluke Komisije i država članica o kojima je obaveštena na osnovu ovog stava.
Komisioni, agjencia dhe autoritetet kompetente të shtetit anëtar në fjalë bashkëpunojnë me qëllim të zbatimit të këtij paragrafi.	The Commission, the Agency and the competent authorities of the Member State concerned shall cooperate for the purpose of the application of this paragraph.	Komisija, Agencija i nadležna tela dotične države članice sarađuju u svrhu primene ovog stava.
7. Shtetet anëtare mund të vendosin që të përjashtojnë nga kjo rregullore dizajnimin,	7. Member States may decide to exempt from this Regulation the design, maintenance and	7. Države članice mogu odlučiti od ove Uredbe izuzeti projektovanje, održavanje i rad

mirëmbajtjen dhe operimin e një aerodromi dhe pajisjeve të ndërlidhura me sigurinë që përdoren në aerodrom, ku ai aerodrom shërben jo më shumë se 10 000 pasagjerë të transportit ajror komercial në vit dhe jo më shumë se 850 lëvizje të ndërlidhura me operimet e ngarkesave (kargo) në vit, dhe me kusht që shtetet anëtare në fjalë sigurojnë që përjashtimi i tillë nuk rrezikon përputhshmërinë me kërkesat thelbësore të referuara në nenin 33.	operation of an aerodrome, and the safety-related equipment used at that aerodrome, where that aerodrome handles no more than 10 000 commercial air transport passengers per year and no more than 850 movements related to cargo operations per year, and provided that Member States concerned ensure that such exemption does not endanger compliance with the essential requirements referred to in Article 33.	aerodroma i opremu povezanu sa bezbednošću koja se upotrebljava na tom aerodromu ako taj aerodrom godišnje nema više od 10 000 putnika u komercijalnom vazdušnom prevozu ni više od 850 kretanja povezanih sa operacijama teretnih vazduhoplova, pod uslovom da dotične države članice osiguraju da se takvim izuzećem ne ugrožava usklađenost sa bitnim zahtevima iz člana 33.
Nga data e specifikuar në atë vendim për përjashtim, dizajnimi, mirëmbajtja dhe operimi i aerodromit në fjalë dhe pajisjeve të ndërlidhura me sigurinë dhe shërbimet në tokë dhe AMS në atë aerodrom nuk rregullohen më me këtë rregullore dhe me aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj.	From the date specified in that exemption decision, the design, maintenance and operation of the aerodrome concerned and the safety-related equipment and groundhandling services and AMS at that aerodrome shall no longer be regulated by this Regulation and by the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof.	Od datuma navedenog u toj odluci o izuzeću ovom Uredbom i delegiranim i sprovedbenim aktima donesenim na osnovu ove Uredbe više se ne uređuju projektovanje, održavanje i rad dotičnog aerodroma kao ni njegova oprema povezana sa bezbednošću i zemaljske usluge i usluge AMS-a na tom aerodromu.
Shteti anëtar në fjalë njofton pa vonesë Komisionin dhe agjencinë për vendimin e tij për përjashtim dhe arsyet për miratimin e tij.	The Member State concerned shall, without delay, notify the Commission and the Agency of its exemption decision and the reasons for the adoption thereof.	Dotična država članica bez odlaganja obaveštava Komisiju i Agenciju o svojoj odluci o izuzeću i razlozima za njeno donošenje.
Nëse Komisioni, pas konsultimit me agjencinë, konsideron se një përjashtim i tillë nga një shtet anëtar nuk është në përputhje me kushtet e specifikuara në nënparagrafin e parë, Komisioni miraton akte zbatuese duke përcaktuar vendimin e tij për atë qëllim. Pas njoftimit të shtetit anëtar në fjalë për aktet e tilla zbatuese, ai shtet anëtar modifikon apo revokon pa vonesë vendimin e tij për përjashtim dhe informon Komisionin dhe agjencinë për këtë.	Where the Commission, after consulting the Agency, considers that such exemption by a Member State does not comply with the conditions specified in the first subparagraph, the Commission shall adopt implementing acts setting out its decision to that effect. Upon notification of such implementing acts to a Member State concerned, that Member State shall without delay modify or revoke its exemption decision and shall inform the Commission and the Agency thereof.	Ako Komisija nakon savetovanja sa Agencijom smatra da takvo izuzeće o kojem je odlučila država članica nije u skladu sa uslovima navedenim u prvom podstavu, Komisija donosi sprovedbene akte kojima se utvrđuje njena odluka u tu svrhu. Nakon što je dotična država članica obaveštena o tim sprovedbenim aktima ta država članica bez odlaganja donosi odluku o izmeni ili ukidanju svoje odluke o izuzeću i o tome obaveštava Komisiju i Agenciju.

Shtetet anëtare gjithashtu njoftojnë Komisionin dhe agjencinë për përjashtimet që i kanë dhënë në bazë të nenit 4(3b) të Rregullores së AAC-së nr. 3/2009.	The Member States shall also notify to the Commission and the Agency the exemptions which they have granted pursuant to Article 4(3b) of CAA Regulation No. 3/2009.	Države članice obaveštavaju Komisiju i Agenciju i o izuzećima koja su odobrile na osnovu člana 4. stava 3.b Uredbe ACV-a br. 3/2009.
Shtetet anëtare ekzaminojnë në baza vjetore shifrat e trafikut të aerodromeve që ato i kanë përjashtuar në bazë të këtij paragrafi apo nenit 4(3b) të Rregullores së AAC-së nr. 3/2009. Nëse me atë ekzaminim demonstrohet që, gjatë tri viteve të njëpasnjëshme, njëri nga ato aerodrome shërben më shumë se 10 000 pasagjerë të transportit ajror komercial në vit apo më shumë se 850 lëvizje në lidhje me operimet e ngarkesave në vit, shteti anëtar në fjalë revokon përjashtimin e atij aerodromi. Në atë rast, informon Komisionin dhe agjencinë në përputhje me rrethanat.	Member States shall, on an annual basis, examine the traffic figures of the aerodromes that they have exempted pursuant to this paragraph or Article 4(3b) of CAA Regulation No. 3/2009. Where that examination demonstrates that, over three consecutive years, one of those aerodromes handles more than 10 000 commercial air transport passengers per year or more than 850 movements related to cargo operations per year, the Member State concerned shall revoke the exemption of that aerodrome. In that case, it shall inform the Commission and the Agency accordingly.	Države članice svake godine pregleđuju podatke o prometu na aerodromima koje su izuzele na osnovu ovog stava ili člana 4. stava 3.b Uredbe ACV-a br. 3/2009. Ako se u tom pregledu pokaže da, tokom tri uzastopne godine, jedan od tih aerodroma godišnje ima više od 10 000 putnika u komercijalnom vazdušnom prevozu ili više od 850 kretanja povezanih sa operacijama teretnih vazduhoplova, dotična država članica ukida izuzeće za taj aerodrom. U tom slučaju o tome obaveštava Komisiju i Agenciju.
Agjencia përfshinë në repozitorin e referuar në nenin 74 të gjitha vendimet e Komisionit dhe të shteteve anëtare të cilat janë njoftuar në bazë të këtij paragrafi.	The Agency shall include in the repository referred to in Article 74 all of the decisions of the Commission and of the Member States that have been notified pursuant to this paragraph.	Agencija u bazu podataka iz člana 74. unosi sve odluke Komisije i država članica o kojima je obaveštena na osnovu ovog stava.
8. Një shtet anëtar mund të vendosë të përjashtojë nga kjo rregullore aktivitetet për dizajnimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe operimin në lidhje me një apo më shumë nga kategoritë të avionëve të paraqitura në vijim:	8. A Member State may decide to exempt from this Regulation the design, production, maintenance and operation activities in respect of one or more of the following categories of aircraft:	8. Država članica može odlučiti od ove Uredbe izuzeti aktivnosti projektovanja, proizvodnje, održavanja i operacija u odnosu na jednu ili više sledećih kategorija vazduhoplova:
(a) aeroplanët, përveç aeroplanëve pa pilot, të cilët nuk kanë më shumë se dy ulëse, shpejtësi të matshme të ngadalësimit (stall speed) apo shpejtësi minimale të fluturimit të qëndrueshëm në konfigurimin e aterrimit prej jo më shumë se 45 nyje të shpejtësisë së	(a) aeroplanes, other than unmanned aeroplanes, which have no more than two seats, measurable stall speed or minimum steady flight speed in landing configuration not exceeding 45 knots calibrated air speed and a maximum take-off mass (MTOM), as	(a) vazduhoplova, osim bespilotnih vazduhoplova, koji nemaju više od dva sedišta, čija merljiva brzina sloma uzgona ili najmanja stalna brzina letenja pri sletanju ne prelazi 45 čvorova kalibrisane brzine, a maksimalna masa pri poletanju (MTOM),

kalibruar ajrore dhe masë maksimale të ngritjes (MTOM), siç është evidentuar nga shteti anëtar, prej jo më shumë se 600 kg për aeroplanët që nuk janë paraparë për operim në ujë apo 650 kg për aeroplanët që janë paraparë për operim në ujë;	recorded by the Member State, of no more than 600 kg for aeroplanes not intended to be operated on water or 650 kg for aeroplanes intended to be operated on water;	kako ju je zabeležila država članica, ne prelazi 600 kg za vazduhoplove koji nisu namenjeni za operacije na vodi ili 650 kg za vazduhoplove koji su namenjeni za operacije na vodi;
(b) helikopterët, përveç helikopterëve pa pilot, të cilët nuk kanë më shumë se dy ulëse dhe një MTOM, siç është evidentuar nga shteti anëtar, prej jo më shumë se 600 kg për helikopterët jo të paraparë të operohen në ujë apo 650 kg për helikopterët e paraparë të operohen në ujë;	(b) helicopters, other than unmanned helicopters, which have no more than two seats and a MTOM, as recorded by the Member State, of no more than 600 kg for helicopters not intended to be operated on water or 650 kg for helicopters intended to be operated on water;	(b) helikoptera, osim bespilotnih helikoptera, koji nemaju više od dva sedišta i čiji MTOM, kako ga je zabeležila država članica, ne prelazi 600 kg za helikoptere koji nisu namenjeni za operacije na vodi ili 650 kg za helikoptere koji su namenjeni za operacije na vodi;
(c) planerët, përveç planerëve pa pilot, dhe planerët me motor, përveç planerëve pa pilot me motor, të cilët nuk kanë më shumë se dy ulëse dhe një MTOM, siç është evidentuar nga shteti anëtar, prej jo më shumë se 600 kg.	(c) sailplanes, other than unmanned sailplanes, and powered sailplanes, other than unmanned powered sailplanes, which have no more than two seats and a MTOM, as recorded by the Member State, of no more than 600 kg.	(c) jedrilica, osim bespilotnih jedrilica, i motorne jedrilice, osim bespilotnih motornih jedrilica, koji nemaju više od dva sedišta i čiji MTOM, kako ga je zabeležila država članica, ne prelazi 600 kg.
Megjithatë, sa i përket kategorive të avionit të referuara në nënparagrafin e parë, shtetet anëtare nuk mund të marrin një vendim të tillë në lidhje me avionin për të cilin është lëshuar, apo konsiderohet se është lëshuar një certifikatë, në përputhje me Rregulloren e AAC-së nr. 3/2009 apo me këtë rregullore, apo në lidhje me të cilin është bërë një deklaratë në përputhje me këtë rregullore.	However, as regards the categories of aircraft referred to in the first subparagraph Member States may not take such a decision concerning aircraft in respect of which a certificate has been issued, or has been deemed to have been issued, in accordance with CAA Regulation No. 3/2009 or with this Regulation, or in respect of which a declaration has been made in accordance with this Regulation.	Međutim, u pogledu kategorija vazduhoplova iz prvog podstava države članice ne moraju doneti takvu odluku u pogledu vazduhoplova za koji je izdat ili se smatra da je izdat sertifikat, u skladu sa Uredbom ACV-a br. 3/2009 ili sa ovom Uredbom ili u vezi sa kojim je data izjava u skladu sa ovom Uredbom.
9. Një vendim për përjashtim i marrë nga një shtet anëtar në bazë të paragrafit 8 nuk pengon një organizatë me vendin kryesor të biznesit në territorin e atij shteti anëtar që të vendosë për	9. An exemption decision taken by a Member State pursuant to paragraph 8 shall not prevent an organisation with a principal place of business in the territory of that Member State	9. Odlukom o izuzeću koju je na osnovu stava 8. donela država članica ne sprečava se organizacija sa glavnim mestom poslovanja na državnom području te države članice da

kryerjen e aktiviteteve të saj të dizajnimit dhe prodhimit, në lidhje me avionin e mbuluar me atë vendim, në përputhje me këtë rregullore dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj. Atëherë kur një organizatë merr një vendim të tillë, ajo informon shtetin anëtar për këtë. Në raste të tilla, vendimi për përjashtim i marrë nga shteti anëtar në bazë të paragrafit 8 nuk vlen për aktivitetet e dizajnimit dhe prodhimit apo për avionin e dizajnuar dhe prodhuar si rezultat i atyre aktiviteteve.	from deciding to carry out its design and production activities in respect of aircraft covered by that decision in accordance with this Regulation and with the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof. Where such an organisation takes such a decision it shall inform the Member State concerned thereof. In such cases, the exemption decision taken by the Member State pursuant to paragraph 8 shall not apply to those design and production activities or to the aircraft designed and produced as a result of those activities.	odluči da sprovodi svoje aktivnosti projektovanja i proizvodnje u pogledu vazduhoplova obuhvaćenih tom odlukom u skladu sa ovom Uredbom te delegiranim i sprovedbenim aktima donesenim na osnovu ove Uredbe. Ako takva organizacija donese takvu odluku, o tome obaveštava dotičnu državu članicu. U takvim slučajevima odluka o izuzeću koju je na osnovu stava 8. donela država članica ne primenjuje se na te aktivnosti projektovanja i proizvodnje ni na vazduhoplove koji su projektovani i proizvedeni kao rezultat tih aktivnosti.
10. Pa cenuar obligimet e shteteve anëtare sipas Konventës së Çikagos, avionët për të cilët vlen vendimi për përjashtim i marrë në bazë të paragrafit 8 dhe të cilët janë të regjistruar në shtetin anëtar që ka marrë atë vendim, mund të operohen në një shtet tjetër anëtar, në varësi të dakordimit të shtetit anëtar në territorin e të cilit realizohet operimi. Avionët e tillë mund të mirëmbahen ose dizajni i tyre të modifikohet në shtetet tjera anëtare, me kusht që aktivitetet e tilla të mirëmbajtjes dhe modifikimet e tilla të dizajnit kryhen nën mbikëqyrjen e shtetit anëtar ku është i regjistruar avioni dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin kombëtar të atij shteti anëtar.	10. Without prejudice to obligations of Member States under the Chicago Convention, aircraft to which the exemption decision taken pursuant to paragraph 8 applies and which are registered in the Member State that took that decision may be operated in other Member States, subject to the agreement of the Member State in the territory of which the operation takes place. Such aircraft may also be maintained, or its design may be modified, in other Member States, provided that such maintenance activities and such design modifications are carried out under the oversight of the Member State where the aircraft is registered and in accordance with procedures established in the national law of that Member State.	10. Ne dovodeći u pitanje obaveze država članica u okviru Čikaške konvencije, vazduhoplovima na koje se primenjuje odluka o izuzeću donesena na osnovu stava 8. i koji su registrovani u državi članici koja je donela tu odluku može se upravljati u drugoj državi članici, podložno saglasnosti države članice na čijem se državnom području tim vazduhoplovima upravlja. Takvi vazduhoplovi mogu se i održavati te se njihov projekat može izmeniti u drugim državama članicama, pod uslovom da se takve aktivnosti održavanja i takve izmene projekta odvijaju pod nadzorom države članice u kojoj je vazduhoplov registrovan i u skladu sa postupcima utvrđenim u nacionalnom pravu te države članice.
Çdo certifikatë që lëshohet në lidhje me avionin për të cilin vlen një vendim për përjashtim i marrë në bazë të paragrafit 8 tregon qartë që ajo certifikatë lëshohet jo sipas kësaj rregulloreje por sipas ligjit	Any certificate that is issued in respect of aircraft to which an exemption decision taken pursuant to paragraph 8 applies shall clearly indicate that that certificate is issued not under this Regulation but	U svakom certifikatu koji je izdat u vezi sa vazduhoplovom na koji se primenjuje odluka o izuzeću donesena na osnovu stava 8. jasno se navodi da sertifikat nije izdat u skladu sa ovom

kombëtar të shtetit anëtar që është duke e lëshuar certifikatën. Shtetet tjera anëtare mund të pranojnë certifikata të tilla kombëtare vetëm nëse ato vetë kanë marrë një vendim korrespondues sipas paragrafit 8.	under the national law of the Member State which is issuing the certificate. Other Member States may accept such national certificates only if they themselves have taken a corresponding decision pursuant to paragraph 8.	Uredbom, već u skladu sa nacionalnim pravom države članice koja izdaje sertifikat. Druge države članice mogu prihvatiti takve nacionalne sertifikate samo ako su i same donele odgovarajuću odluku na osnovu stava 8.
Çdo dispozitë e ligjit kombëtar të shtetit anëtar, i cili ka marrë vendim për përjashtim sipas paragrafit 8, që rregullon aktivitetet e dizajnimit, prodhimit, mirëmbajtjes dhe operimit të avionit për të cilin vlen ai vendim janë në proporcion me natyrën dhe rrezikun e aktivitetit në fjalë dhe merr parasysh objektivat dhe parimet e përcaktuara në nenet 1 dhe nenin 4, përkatësisht.	Any provisions of national law of the Member State which has taken an exemption decision pursuant to paragraph 8 regulating the design, production, maintenance and operation activities of the aircraft to which that decision applies shall be proportionate to the nature and risk of the activity concerned and shall take account of the objectives and principles set out in Articles 1 and 4 respectively.	Sve odredbe nacionalnog prava države članice koja je na osnovu stava 8. donela odluku o izuzeću, a kojima se uređuju aktivnosti projektovanja, proizvodnje, održavanja i operacija vazduhoplova na koje se ta odluka odnosi moraju biti proporcionalne prirodi dotične aktivnosti i riziku povezanom sa njom te se njima moraju uzimati u obzir ciljevi i načela utvrđeni u članu 1., odnosno članu 4.
Shteti anëtar që ka marrë vendim për përjashtim sipas paragrafit 8 e njofton pa vonesë Komisionin dhe agjencinë për atë vendim dhe iu jep të gjitha informacionet relevante dhe në veçanti datën nga e cila vlen ai vendim dhe kategorinë e avionit me të cilën ka të bëjë.	The Member State which has taken an exemption decision pursuant to paragraph 8 shall, without delay, notify the Commission and the Agency of that decision and provide them with all relevant information, and in particular the date from which the that decision applies and the category of aircraft that it concerns.	Država članica koja je na osnovu stava 8. donela odluku o izuzeću bez odlaganja obaveštava Komisiju i Agenciju o toj odluci i pruža im sve relevantne informacije, a posebno informacije o datumu od kojeg se ta odluka primenjuje i kategoriji vazduhoplova na koje se odnosi.
Një shtet anëtar mund të vendosë për modifikimin apo revokimin e një vendimi për përjashtim që e ka marrë në bazë të paragrafit 8. Në raste të tilla, ai informon pa vonesë Komisionin dhe agjencinë për këtë.	A Member State may decide to modify or revoke an exemption decision that it has taken pursuant to paragraph 8. In such cases, it shall without delay inform the Commission and the Agency thereof.	Država članica može odlučiti izmeniti ili ukinuti odluku o izuzeću koju je donela na osnovu stava 8. U takvim slučajevima ona o tome bez odlaganja obaveštava Komisiju i Agenciju.
Agjencia përfshinë në repozitorin e referuar në nenin 74 të gjitha vendimet e shteteve anëtare të cilat janë njoftuar sipas këtij paragrafi.	The Agency shall include in the repository referred to in Article 74 all of the decisions of the Member States that have been notified pursuant to this paragraph.	Agencija u bazu podataka iz člana 74. unosi sve odluke država članica o kojima je obaveštena na osnovu ovog stava.

Vendimi për përjashtim i marrë nga një shtet anëtar në bazë të paragrafit 8 vlen edhe për organizatat dhe personelin e përfshirë në aktivitetet e dizajnimit, prodhimit, mirëmbajtjes dhe operimit për të cilat vlen ai vendim.	An exemption decision taken by a Member State pursuant to paragraph 8 shall also apply to the organisations and personnel involved in the design, production, maintenance and operation activities to which that decision applies.	Odluka o izuzeću koju je na osnovu stava 8. donela država članica takođe se primenjuje na organizacije i osoblje uključene u aktivnosti projektovanja, proizvodnje, održavanja i operacija na koje se ta odluka primenjuje.
Neni 3 **Përkufizimet**	**Article 3** **Definitions**	**Član 3** **Definicije**
1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, vlejnë këto përkufizime:	1. For the purposes of this Regulation, the following definitions apply:	1. Za potrebe ove Uredbe primenjuju se sledeće definicije:
(1) 'mbikëqyrje' nënkupton verifikimin e vazhdueshëm, nga apo në emër të autoritetit kompetent, që kërkesat që dalin nga kjo rregullore dhe aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, në bazë të të cilave është lëshuar një certifikatë apo është bërë një deklaratë, vazhdojnë të respektohen;	(1) 'oversight' means the verification, by or on behalf of the competent authority, on a continuous basis that the requirements of this Regulation and of the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, on the basis of which a certificate has been issued or in respect of which a declaration has been made, continue to be complied with;	(1) „nadzor" znači proveravanje, od strane ili u ime nadležnog tela, na kontinuiranoj osnovi, jesu li zahtevi iz ove Uredbe i iz delegiranih i sprovedbenih akata donesenih na osnovu ove Uredbe, na osnovu kojih je sertifikat izdat ili u odnosu na koje je data izjava, i dalje ispunjeni;
(2) 'Konventa e Çikagos' nënkupton Konventën për Aviacionin Ndërkombëtar Civil dhe shtojcat e saj, nënshkruar në Çikago më 7 dhjetor 1944;	(2) 'Chicago Convention' means the Convention on International Civil Aviation and the Annexes thereto, signed in Chicago on 7 December 1944;	(2) „Čikaška konvencija" znači Konvencija o međunarodnom civilnom vazduhoplovstvu i njeni aneksi, potpisana u Čikagu 7. decembra 1944;
(3) 'produkt' nënkupton një avion, motor apo helikë;	(3) 'product' means an aircraft, an engine or a propeller;	(3) „proizvod" znači vazduhoplov, motor ili propeler;
(4) 'pjesë' nënkupton çdo element të një produkti, siç përcaktohet nga dizajni i tipit të atij produkti;	(4) 'part' means any element of a product, as defined by that product's type design;	(4) „deo" znači bilo koji element proizvoda kako je utvrđen projektom tog tipa proizvoda;

(5) 'MTA/SHNA' nënkupton menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror dhe mbulon të gjitha nga këto në vijim: funksionet dhe shërbimet e menaxhimit të trafikut ajror siç përcaktohen në pikën (10) të nenit 2 të Rregullores së AAC-së nr. 8/2009; shërbimet e navigacionit ajror siç përcaktohen në pikën (4) të nenit 2 të asaj rregulloreje, duke përfshirë funksionet dhe shërbimet e menaxhimit të rrjetit të referuara në nenin 6 të Rregullores së AAC-së nr. 10/2009, si dhe shërbimet që përmirësojnë sinjalet e emetuara nga satelitët e konstalacioneve kryesore të GNSS për qëllime të navigacionit ajror; dizajnimin e procedurave të fluturimit; dhe shërbimet që përfshijnë gjenerimin dhe përpunimin e të dhënave dhe formatimin dhe dërgimin e të dhënave tek trafiku i përgjithshëm ajror për qëllime të navigacionit ajror;	(5) 'ATM/ANS' means air traffic management and air navigation services and covers all of the following: the air traffic management functions and services as defined in point (10) of Article 2 of CAA Regulation No 8/2009; the air navigation services as defined in point (4) of Article 2 of that Regulation, including the network management functions and services referred to in Article 6 of CAA Regulation No. 10/2009, as well as services which augment signals emitted by satellites of core constellations of GNSS for the purpose of air navigation; flight procedures design; and services consisting in the origination and processing of data and the formatting and delivering of data to general air traffic for the purpose of air navigation;	(5) „ATM/ANS" znači upravljanje vazdušnim saobraćajem i usluge u vazdušnom saobraćaju i obuhvata sve od sledećeg: funkcije i usluge upravljanja vazdušnim prometom kako su definisane u članu 2. tački 10. Uredbe ACV-a br. 8/2009; usluge u vazdušnom saobraćaju kako su definisane u članu 2. tački 4. te uredbe, uključujući funkcije i usluge upravljanja mrežom iz člana 6. Uredbe ACV-a br. 10/2009, kao i usluge kojima se pojačavaju signali koje odašilju sateliti glavnih konstelacija GNSS-a za potrebe vazdušne navigacije; oblikovanje postupaka letenja; te usluge koje se sastoje od stvaranja i obrade podataka i formatiranja i isporuke podataka opštem vazdušnom saobraćaju za potrebe vazdušne navigacije;
(6) 'pjesë përbërëse të MTA/SHNA' nënkupton objektet e prekshme, si harduer, dhe objektet e paprekshme, si softuer, nga të cilat varet interoperabiliteti i EATMN;	(6) 'ATM/ANS constituent' means tangible objects such as hardware and intangible objects such as software upon which the interoperability of the EATMN depends;	(6) „sastavni deo ATM-a/ANS-a" znači materijalni predmeti, poput hardvera, i nematerijalni predmeti, poput softvera, od kojih zavoso interoperabilnost EATMN-a;
(7) 'sistem i MTA/SHNA' nënkupton grumbullin e pjesëve përbërëse ajrore dhe tokësore, si dhe pajisjeve hapësinore, të cilat mbështesin shërbimet e navigacionit ajror për të gjitha fazat e fluturimit;	(7) 'ATM/ANS system' means the aggregation of airborne and ground-based constituents, as well as space-based equipment, that provides support for air navigation services for all phases of flight;	(7) „sistem ATM-a/ANS-a" znači skup sastavnih delova u vazduhu i na tlu, kao i satelitskih uređaja, kojim se pruža podrška uslugama u vazdušnoj navigaciji u svim fazama leta;
(8) 'Master Plani i MTA' nënkupton planin e miratuar për Master Planin e Menaxhimit të	(8) 'ATM Master Plan' means the plan endorsed by the European Air Traffic	(8) „glavni plan ATM-a" znači plan odobren o Master planu upravljanja vadušnim

Trafikut Ajror Evropian të Projektit Kërkimor të MTA të Qiellit të Vetëm Evropian (SESAR), në përputhje me nenin 1(2) të Rregullores së AAC-së nr. 17/2010;	Management Master Plan of the Single European Sky ATM Research (SESAR) Project, in accordance with Article 1(2) of CAA Regulation No 17/2010;	saobraćajem u jedinstvenog evropskog neba u okviru projekta ATM istraživanja (SESAR), u skladu sa članom 1. stavom 2. Uredbe ACV-a br. 17/2010;
(9) 'certifikim' nënkupton ndonjë formë të njohjes në përputhje me këtë rregullore, në bazë të vlerësimit të duhur, që një person juridik apo fizik, produkt, pjesë, pajisje jo e instaluar, pajisje për kontrollimin nga distanca të avionit pa pilot, aerodrom, pajisje të aerodromit të ndërlidhura me sigurinë, sistemin e MTA/SHNA, pjesët përbërëse të MTA/SHNA apo mjeti simulues fluturimi për trajnim përmbushë kërkesat e aplikueshme të kësaj rregulloreje dhe të akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, nëpërmjet lëshimit të një certifikate që dëshmon përputhjen e tillë;	(9) 'certification' means any form of recognition in accordance with this Regulation, based on an appropriate assessment, that a legal or natural person, product, part, non-installed equipment, equipment to control unmanned aircraft remotely, aerodrome, safety-related aerodrome equipment, ATM/ANS system, ATM/ANS constituent or flight simulation training device complies with the applicable requirements of this Regulation and of the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, through the issuance of a certificate attesting such compliance;	(9) „sertifikacija" znači svaki oblik priznavanja u skladu sa ovom Uredbom, na osnovu odgovarajuće ocene, da je pravno ili fizičko lice, proizvod, deo, neugrađena oprema, oprema za daljinsko upravljanje bespilotnim vazduhoplovom, aerodrom, aerodromska oprema povezana sa bezbednošću, sistem ATM-a/ANS-a, sastavni deo ATM-a/ANS-a ili uređaj za osposobljavanje koji simulira let u skladu sa primenjivim zahtevima iz ove Uredbe te iz delegiranih i sprovedbenih akata donesenih na osnovu ove Uredbe putem izdavanja odgovarajućeg sertifikata kojim se potvrđuje takva usklađenost;
(10) 'deklarata' nënkupton deklaratën me shkrim të bërë në përputhje me këtë rregullore nën përgjegjësinë e vetme të personit juridik apo fizik që i nënshtrohet kësaj rregulloreje dhe e cila konfirmon se respektohen kërkesat e aplikueshme të kësaj rregulloreje dhe të akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj në lidhje me një person juridik apo fizik, produkt, pjesë, pajisje jo të instaluar, pajisje për kontrollin nga distanca të avionit pa pilot, pajisje të aerodromit të ndërlidhura me sigurinë, sistemin e MTA/SHNA, pjesët	(10) 'declaration' means any written statement made in accordance with this Regulation under the sole responsibility of a legal or natural person subject to this Regulation and which confirms that the applicable requirements of this Regulation and of the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof relating to a legal or natural person, product, part, non-installed equipment, equipment to control unmanned aircraft remotely, safety-related aerodrome equipment, ATM/ANS system, ATM/ANS	(10) „izjava" znači svaka pisana izjava data u skladu sa ovom Uredbom pod isključivom odgovornošću pravnog ili fizičkog lica na koje se primenjuje ova Uredba, a kojom se potvrđuje usklađenost sa primenjivim zahtevima iz ove Uredbe te iz sprovedbenih i delegiranih akata donesenih na osnovu ove Uredbe u pogledu pravnog ili fizičkog lica, proizvoda, dela, neugrađene opreme, opreme za daljinsko upravljanje bespilotnim vazduhoplovom, aerodromske opreme povezane sa bezbednošću, sistema ATM-a/ANS-a, sastavnog dela ATM-

përbërëse të MTA/SHNA apo mjet simulues i fluturimit për trajnim;	constituent or flight simulation training device are complied with;	a/ANS-a ili uređaja za osposobljavanje koji simulira let;
(11) 'subjekt i kualifikuar' nënkupton një person të akredituar juridik apo fizik që mund të ngarkohet me detyra të caktuara të certifikimit apo mbikëqyrjes sipas kësaj rregulloreje nga dhe nën kontrollin dhe përgjegjësinë e agjencisë apo autoritetit kompetent kombëtar;	(11) 'qualified entity' means an accredited legal or natural person which may be charged with certain certification or oversight tasks under this Regulation by and under the control and the responsibility of the Agency or a national competent authority;	(11) „kvalifikovan subjekat" znači akreditovano pravno ili fizičko lice kome Agencija ili nacionalno nadležno telo može dodeliti određene zadatke sertifikacije ili nadzora u skladu sa ovom Uredbom, pod kontrolom i odgovornošću Agencije, odnosno navedenog tela;
(12) 'certifikatë' nënkupton certifikatën, aprovimin, licencën, autorizimin, vërtetimin apo ndonjë dokument tjetër të lëshuar si rezultat i certifikimit që dëshmon përputhshmërinë me kërkesat e aplikueshme;	(12) 'certificate' means any certificate, approval, licence, authorisation, attestation or other document issued as the result of a certification attesting compliance with the applicable requirements;	(12) „sertifikat" znači svaki sertifikat, odobrenje, dozvola, dopuštenje, potvrda ili drugi dokument izdat kao rezultat sertifikacije kojim se potvrđuje usklađenost sa primenjivim zahtevima;
(13) 'operator i avionit' nënkupton çdo person juridik apo fizik që operon apo propozon të operojë një apo më shumë avionë;	(13) 'aircraft operator' means any legal or natural person operating or proposing to operate one or more aircraft;	(13) „operator vazduhoplova" znači svako pravno ili fizičko lice koje upravlja ili namerava upravljati jednim ili više vazduhoplova;
(14) 'operator i aerodromit' nënkupton çdo person juridik apo fizik që operon apo propozon të operojë një apo më shumë aerodrome;	(14) 'aerodrome operator' means any legal or natural person operating or proposing to operate one or more aerodromes;	(14) „operator aerodroma" znači svako pravno ili fizičko lice koje upravlja ili namerava upravljati jednim ili više aerodroma;
(15) 'mjet simulues fluturimi për trajnim' nënkupton çdo lloj mjeti në të cilin simulohen kushtet e fluturimit në tokë, përfshirë simuluesit e fluturimit, mjetet trajnuese të fluturimit, mjetet për ushtrimin e procedurave të fluturimit dhe navigacionit dhe mjetet për ushtrimin e procedurave bazë me instrumente;	(15) 'flight simulation training device' means any type of device in which flight conditions are simulated on the ground, including flight simulators, flight training devices, flight and navigation procedures trainers and basic instrument training devices;	(15) „uređaj za osposobljavanje koji simulira let" znači svaka vrsta uređaja kojim se na tlu simuliraju uslovi letenja, uključujući simulatore letenja, uređaje za letačko osposobljavanje, uređaje za vežbanje letačkih i navigacijskih procedura i uređaje za vežbanje osnovnih instrumentalnih procedura;

(16) ‘aerodrom’ nënkupton një zonë të përcaktuar, në tokë apo në ujë, në strukturë fikse, fikse në det dhe strukturë lundruese, përfshirë ndërtesat, instalimet dhe pajisjet në to, që synohen të përdoren tërësisht apo pjesërisht për ardhjen, nisjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionit;	(16) ‘aerodrome’ means a defined area, on land or on water, on a fixed, fixed offshore or floating structure, including any buildings, installations and equipment thereon, intended to be used either wholly or in part for the arrival, departure and surface movement of aircraft;	(16) „aerodrom” znači određeno područje na kopnu ili na vodi, na nepokretnoj strukturi, nepokretnoj odobalnoj strukturi ili plutajućoj strukturi, uključujući sve zgrade, instalacije i opremu na njemu, u celosti ili delimično namenjeno za sletanje, uzletanje i površinsko kretanje vazduhoplova;
(17) ‘pajisje të aerodromit të ndërlidhura me sigurinë’ nënkupton çdo instrument, pajisje, mekanizëm, aparaturë, pajisje shtesë, softuer apo aksesor që përdoret apo synohet të përdoret për të kontribuuar në operimin e sigurt të avionit në një aerodrom;	(17) ‘safety-related aerodrome equipment’ means any instrument, equipment, mechanism, apparatus, appurtenance, software or accessory that is used or intended to be used to contribute to the safe operation of aircraft at an aerodrome;	(17) „aerodromska oprema povezana sa bezbednošću” znači svaki instrument, oprema, mehanizam, uređaj, pribor, softver ili dodatna oprema koji se upotrebljavaju ili su namenjeni za upotrebu kao doprinos bezbednim operacijama vazduhoplova na aerodromu;
(18) ‘platformë’ nënkupton një zonë të përcaktuar të një aerodromi të paraparë për t’i akomoduar avionët për qëllime të ngarkimit apo shkarkimit të pasagjerëve, bagazhit, postës apo ngarkesës, karburantit, parkimit apo mirëmbajtjes;	(18) ‘apron’ means a defined area of an aerodrome intended to accommodate aircraft for purposes of loading or unloading passengers, baggage, mail or cargo, fuelling, parking or maintenance;	(18) „stajanka” znači određeno područje aerodroma namenjeno za smeštaj vazduhoplova u svrhu ukrcaja i iskrcaja putnika, prtljaga, pošte ili tereta, punjenja goriva, parkiranja ili održavanja;
(19) ‘Shërbime për Menaxhimin e Platformës (AMS)’ nënkupton një shërbim të ofruar për rregullimin e aktiviteteve dhe lëvizjen e avionit dhe automjeteve në një platformë;	(19) ‘apron management service (AMS)’ means a service provided to regulate the activities and the movement of aircraft and vehicles on an apron;	(19) „usluga upravljanja postupcima na stajanci (usluga AMS-a)” znači usluga regulisanja aktivnosti i kretanja vazduhoplova i vozila na stajanci;
(20) ‘shërbimi për informacione të fluturimit’ nënkupton një shërbim të ofruar me qëllim të dhënies së këshillave dhe informacioneve të dobishme për realizimin e sigurt dhe efikas të fluturimeve;	(20) ‘flight information service’ means a service provided for the purpose of giving advice and information useful for the safe and efficient conduct of flights;	(20) „usluga letnih informacija” znači usluga koja se pruža u svrhu davanja saveta i informacija korisnih za bezbedno i efikasno izvođenje letova;

(21) ‘trafik i përgjithshëm ajror’ nënkupton të gjitha lëvizjet e avionëve civilë dhe avionëve shtetërorë të kryera në përputhje me procedurat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (‘ICAO’);	(21) ‘general air traffic’ means all movements of civil aircraft and state aircraft carried out in conformity with the procedures of the International Civil Aviation Organization (‘ICAO’);	(21) „opšti vazdušni saobraćaj” znači sva kretanja civilnih i državnih vazduhoplova koja se obavljaju u skladu sa postupcima Međunarodne organizacije civilnog vazduhoplovstva (‘ICAO’);
(22) ‘standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara’ nënkupton standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara të miratuara nga ICAO në përputhje me nenin 37 të Konventës së Çikagos;	(22) ‘international standards and recommended practices’ means the international standards and recommended practices adopted by ICAO in accordance with Article 37 of the Chicago Convention;	(22) „međunarodni standardi i preporučene prakse” znači međunarodni standardi i preporučene prakse koje je doneo ICAO u skladu sa članom 37. Čikaške konvencije;
(23) ‘shërbime në tokë’ nënkupton shërbimet e ofruara në aerodrome që përfshijnë aktivitetet e ndërlidhura me sigurinë në fushat e mbikëqyrjes në tokë, dispeçerin e fluturimeve dhe kontrollin e ngarkesës, shërbimin e pasagjerëve, trajtimin e bagazhit, trajtimin e mallrave dhe postës, manipulimin e avionit në platformë, shërbimet e avionit, trajtimin e derivateve dhe vajrave, dhe ngarkimin e furnizimeve të ushqimeve; përfshirë edhe rastet kur operatorët e avionit i sigurojnë vetë këto shërbime në tokë (vetëshërbimi);	(23) ‘groundhandling service’ means any service provided at aerodromes comprising safety - related activities in the areas of ground supervision, flight dispatch and load control, passenger handling, baggage handling, freight and mail handling, apron handling of aircraft, aircraft services, fuel and oil handling, and loading of catering; including the case where aircraft operators provide those groundhandling services to themselves (self-handling);	(23) „zemaljska usluga” znači svaka usluga koja se pruža na aerodromima i sastoji se od aktivnosti povezanih sa bezbednošću u području zemaljskog nadzora, otpreme leta i kontrole utovara, poslova sa putnicima, rukovanja prtljagom, rukovanja teretom i poštom, rukovanja vazduhoplovom na stajanci, usluga na vazduhoplovima, rukovanja gorivom i mazivom te utovara keteringa; uključujući slučajeve u kojima operatori vazduhoplova pružaju te zemaljske usluge sami sebi (samostalno obavljanje usluga);
(24) ‘transporti ajror komercial’ nënkupton operimin e avionit për transportimin e pasagjerëve, ngarkesës apo postës për pagesë apo kompensim tjetër me vlerë;	(24) ‘commercial air transport’ means an aircraft operation to transport passengers, cargo or mail for remuneration or other valuable consideration;	(24) „komercijalni vazdušni prevoz” znači operacija vazduhoplova namenjena za prevoz putnika, tereta ili pošte uz naplatu ili drugu vrstu naknade;
(25) ‘performansë e sigurisë’ nënkupton arritjen e sigurisë të Unionit, shtetit anëtar apo të një organizate, siç përcaktohet nga caqet e	(25) ‘safety performance’ means the Union's, a Member State's or an organisation's safety achievement, as defined by its safety	(25) „performansa bezbednosti” znači uspešnost Unije, države članice ili organizacije u području bezbednosti, kako je definisano

performansës së sigurisë dhe treguesit e performansës së sigurisë;	performance targets and safety performance indicators;	njenim ciljevima performanse bezbednosti i pokazateljima performanse bezbednosti;
(26) 'treguesi i performansës së sigurisë' nënkupton parametrin e përdorur për monitorimin dhe vlerësimin e performansës së sigurisë;	(26) 'safety performance indicator' means a parameter used for monitoring and assessing safety performance;	(26) „pokazatelj performanse bezbednosti" znači parametar koji se upotrebljava za praćenje i ocenjivanje performanse bezbednosti;
(27) 'caku i performansës së sigurisë' nënkupton objektivin e planifikuar apo të synuar për përmbushjen e treguesve të performansës së sigurisë gjatë një periudhe të caktuar kohore;	(27) 'safety performance target' means a planned or intended objective for complying with safety performance indicators over a given period of time;	(27) „cilj performanse bezbednosti" znači planirani ili nameravani cilj radi usklađenosti sa pokazateljima performanse bezbednosti tokom određenog perioda;
(28) 'avion' nënkupton çdo mjet që mund të derivojë mbështetje në atmosferë përmes reaksioneve të ajrit që janë ndryshe prej reaksioneve të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës;	(28) 'aircraft' means any machine that can derive support in the atmosphere from the reactions of the air other than reactions of the air against the earth's surface;	(28) „vazduhoplov" znači svaka naprava koja se može održati u atmosferi zbog reakcija vazduha koje nisu reakcije vazduha u odnosu na zemljinu površinu;
(29) 'pajisje jo e instaluar' nënkupton çdo instrument, pajisje, mekanizëm, aparaturë, pajisje shtesë, softuer apo aksesor që bartet në bordin e një avioni nga operatori i avionit, që nuk është pjesë dhe që përdoret apo është paraparë të përdoret në operimin apo kontrollimin e një avioni, mbështetë mbijetesën e personave në avion, apo që mund të ndikojë në operimin e sigurt të avionit;	(29) 'non-installed equipment' means any instrument, equipment, mechanism, apparatus, appurtenance, software or accessory carried on board of an aircraft by the aircraft operator, which is not a part, and which is used or intended to be used in operating or controlling an aircraft, supports the occupants' survivability, or which could impact the safe operation of the aircraft;	(29) „neugrađena oprema" znači svaki instrument, oprema, mehanizam, uređaj, pribor, softver ili dodatna oprema koje operator vazduhoplova unese u vazduhoplov, ali koji nisu deo, a upotrebljavaju se ili su namenjeni za upravljanje vazduhoplovom ili njegovu kontrolu, povećavaju sposobnost preživljavanja osoba u vazduhoplovu ili bi mogli uticati na bezbedno upravljanje vazduhoplovom;
(30) 'avion pa pilot' nënkupton çdo avion që operon apo është i dizajnuar të operojë në mënyrë autonome apo të pilotohet nga distanca pa pilot në bord;	(30) 'unmanned aircraft' means any aircraft operating or designed to operate autonomously or to be piloted remotely without a pilot on board;	(30) „bespilotni vazduhoplov" znači svaki vazduhoplov koji samostalno izvodi operacije ili je projektovan da samostalno izvodi operacije ili da se njime upravlja na daljinu bez pilota u vazduhoplovu;

(31) 'pilot nga distanca' nënkupton një person fizik që është përgjegjës për realizimin e sigurt të fluturimit të një avioni pa pilot duke operuar pajisjet e tij të komandimit, qoftë në mënyrë manuale apo, kur avioni pa pilot fluturon në mënyrë automatike, duke monitoruar drejtimin e tij dhe duke mbetur në gjendje që të intervenojë dhe ndryshojë drejtimin në çdo kohë;	(31) 'remote pilot' means a natural person responsible for safely conducting the flight of an unmanned aircraft by operating its flight controls, either manually or, when the unmanned aircraft flies automatically, by monitoring its course and remaining able to intervene and change the course at any time;	(31) „pilot koji upravlja na daljinu" znači fizičko lice odgovorno za bezbedno upravljanje letom bespilotnog vazduhoplova koja upravlja njegovim komandama leta, bilo ručno ili, kada bespilotni vazduhoplov leti na automatizovan način, praćenjem njegovog pravca letenja uz mogućnost intervencije i promene pravca u svakom trenutku;
(32) 'pajisja për kontrollin nga distanca të avionit pa pilot' nënkupton çdo instrument, pajisje, mekanizëm, aparaturë, pajisje shtesë, softuer apo aksesor që është i nevojshëm për operimin e sigurt të një avioni pa pilot, i cili nuk është pjesë, si dhe i cili nuk bartet në bord të atij avioni pa pilot;	(32) 'equipment to control unmanned aircraft remotely' means any instrument, equipment, mechanism, apparatus, appurtenance, software or accessory that is necessary for the safe operation of an unmanned aircraft, which is not a part, and which is not carried on board of that unmanned aircraft;	(32) „oprema za daljinsko upravljanje bespilotnim vazduhoplovom" znači svaki instrument, oprema, mehanizam, uređaj, pribor, softver ili dodatna oprema koji su potrebni za bezbedne operacije bespilotnog vazduhoplova, a koji nisu deo i koji se ne nalaze u tom bespilotnom vazduhoplovu;
(33) 'Hapësira ajrore e qiellit të vetëm evropian' nënkupton hapësirën ajrore mbi territorin për të cilin aplikohen traktatet, si dhe çdo hapësirë tjetër ajrore ku shtetet anëtare zbatojnë Rregulloren e AAC-së nr. 10/2009 në përputhje me nenin 1(3) të asaj rregulloreje;	(33) 'Single European Sky airspace' means airspace above the territory to which the Treaties apply, as well as any other airspace where Member States apply CAA Regulation No. 10/2009 in accordance with Article 1(3) of that Regulation;	(33) „vazdušni prostor jedinstvenog evropskog neba" znači vazdušni prostor iznad područja na kojem se primenjuju Ugovori te svaki drugi vazdušni prostor u kojem države članice primenjuju Uredbu ACV-a br. 10/2009 u skladu sa članom 1. stavom 3. te uredbe;
(34) 'autoriteti kompetent kombëtar' nënkupton një apo më shumë subjekte të caktuara nga një shtet anëtar dhe që kanë kompetencat e nevojshme dhe përgjegjësitë e ndara për kryerjen e detyrave në lidhje me certifikimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin në përputhje me këtë rregullore dhe me aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj dhe me Rregulloren e AAC-së nr. 8/2009.	(34) 'national competent authority' means one or more entities designated by a Member State and having the necessary powers and allocated responsibilities for performing the tasks related to certification, oversight and enforcement in accordance with this Regulation and with the delegated and implementing acts adopted on the basis	(34) „nacionalno nadležno telo" znači jedan ili više subjekata koje je odredila država članica i koji imaju potrebna ovlašćenja i dodeljene odgovornosti za obavljanje zadataka u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa u skladu sa ovom Uredbom i u skladu sa delegiranim i sprovedbenim aktima

	thereof, and with CAA Regulation No 8/2009.	donesenim na osnovu ove Uredbe kao i u skladu sa Uredbom ACV-a br. 8/2009.
2. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, termet "Bashkimi Evropian", "Unioni", "Komuniteti", "Traktati i KE-së", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "Transportuesi Ajror i Komunitetit" dhe "Shteti/Shtetet Anëtare", të referuara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në këtë rregullore, lexohen në përputhje me pikat 2 dhe 3 të shtojcës II të Marrëveshjes së HPEA.	2. Notwithstanding above paragraph, terms "European Union", "Union", "Community", "EC Treaty", "Official Journal of the European Union", "Community air carrier" and "Member State(s)", referred to directly or indirectly in this Regulation, shall be read in accordance with Points 2 and 3 of Annex II to the ECAA Agreement.	2. Ne dovodeći u pitanje prethodni stav, izrazi „Evropska unija", „Unija", „Zajednica", „Ugovor o Evropskoj uniji", „Službeni list Evropske unije", „vazdušni prevoznik Zajednice" i „država članica (e)", direktno ili indirektno u ovoj Uredbi, tumače se u skladu sa tačkama 2. i 3. Aneksa II Sporazuma ECAA.
Në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë për detyrat e rialokuara në përputhje me këtë paragraf, zbatohen kapitujt II dhe IV dhe nenet 131 dhe 132, si dhe dispozitat e zbatueshme të ligjit kombëtar të Shtetit Anëtar pranues.	In relation to the exercise of the responsibility for the tasks reallocated in accordance with this paragraph, Chapters II and IV and Articles 131 and 132, as well as the applicable provisions of the national law of the accepting Member State, shall apply.	U vezi sa ispunjavanjem odgovornosti za zadatke preraspodeljene u skladu sa ovim stavom primenjuju se poglavlja II i IV i članovi 131. i 132., kao i primenjive odredbe nacionalnog prava države članice koja je prihvatila zahtev.
3. Sa i përket zbatimit, Shteti Anëtar që ka pranuar kërkesën, ose Agjencia, do të jetë përgjegjës vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me procedurat që çojnë deri në miratimin e vendimeve nga autoriteti kompetent kombëtar i atij Shteti Anëtar, ose Agjencisë, dhe që kanë të bëjnë me detyrat e certifikimit dhe mbikëqyrjes të rialokuara atij në përputhje me këtë nen, si dhe me zbatimin e atyre vendimeve. Për të gjitha çështjet e tjera lidhur me zbatimin, alokimi i përgjegjësive të parashikuara në këtë Rregullore dhe në aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj mbetet i paprekur.	3. As regards enforcement, the Member State which accepted the request, or the Agency, shall only be responsible for matters related to the procedures leading up to the adoption of decisions by the national competent authority of that Member State, or of the Agency, and pertaining to the certification and oversight tasks reallocated to it in accordance with this Article, as well as to the application of those decisions. For all other matters regarding enforcement, the allocation of responsibilities provided for in this Regulation and in the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof shall remain unaffected.	3. U pogledu osiguravanja sprovođenja propisa država članica koja je prihvatila zahtev ili Agencija odgovorna je samo za pitanja u vezi sa postupcima koji vode do donošenja odluka nacionalnog nadležnog tela te države članice ili Agencije i u vezi sa zadacima sertifikacije i nadzora koji su joj preraspodeljeni u skladu sa ovim članom, kao i u vezi sa primenom tih odluka. Za sva ostala pitanja koja se odnose na osiguravanje sprovođenja propisa, dodela odgovornosti predviđena u ovoj Uredbi i u delegiranim i sprovedbenim aktima donesenim na osnovu ove Uredbe ostaje nepromenjena.
4. Agjencia ose Shteti Anëtar, sipas rastit, pranon kërkesën e përmendur në paragrafin 1 ose 2 vetëm kur Agjencia ose autoriteti kompetent kombëtar i Shtetit Anëtar në fjalë konsideron se ka burimet e nevojshme dhe mund të ushtrojë në mënyrë efektive përgjegjësinë për detyrat në fjalë.	4. The Agency or a Member State, as applicable, shall only accept the request referred to in paragraph 1 or 2 when the Agency or the national competent authority of the Member State concerned considers that it has the necessary resources and it can effectively exercise the responsibility for the tasks concerned.	4. Agencija ili država članica, u zavisnosti od slučaja, zahtev iz stava 1. ili stava 2. prihvata samo ako Agencija ili nacionalno nadležno telo dotične države članice smatra da ima potrebne resurse i da može efikasno ispuniti odgovornost u vezi sa dotičnim zadacima.
5. Kur një Shtet Anëtar dëshiron të zbatojë paragrafin 1 ose 2, realizon me Agjencinë ose me Shtetin tjetër Anëtar, sipas rastit, aranzhime të hollësishme lidhur me rialokimin e përgjegjësisë	5. When a Member State wishes to apply paragraph 1 or 2, it shall conclude with the Agency or with the other Member State, as applicable, detailed arrangements concerning	5. Kada država članica želi da primeni stav 1. ili stav 2., ona sklapa sa Agencijom ili drugom državom članicom, u zavisnosti od slučaja, detaljne aranžmane u pogledu preraspodele

për detyrat në fjalë. Personat fizik dhe juridik të prekur nga rialokimi dhe, në rast të rialokimit të përmendur në paragrafin 2, Agjencia, duhet të konsultohen në mënyre të hollësishme para se këto aranzhime të finalizohen. Këto aranzhime të detajuara, të paktën, identifikojnë qartë detyrat të cilat janë duke u rialokuar, dhe përfshijnë aranzhimet ligjore, praktike dhe administrative të nevojshme për të siguruar një transferim të rregullt dhe vazhdimin efektiv dhe të pandërprerë të kryerjes së detyrave në fjalë në përputhje me këtë Rregullore dhe me aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, si dhe një vazhdimësi të patëmetë të aktiviteteve të ndërmarra nga personat fizik dhe juridik në fjalë. Aranzhimet e hollësishme gjithashtu përfshijnë dispozita për transferimin e të dhënave dhe dokumentacionit përkatës teknik.	the reallocation of responsibility for the tasks in question. The natural and legal persons concerned by the reallocation and, in case of the reallocation referred to in paragraph 2, the Agency, shall be consulted on those detailed arrangements before they are finalised. Those detailed arrangements shall, at least, identify clearly the tasks which are being reallocated, and shall include the legal, practical and administrative arrangements necessary to ensure an orderly transfer and the effective and uninterrupted continuation of the performance of the tasks concerned in compliance with this Regulation and with the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, as well as a seamless continuation of the activities undertaken by the natural and legal persons concerned. The detailed arrangements shall also include provisions on the transfer of relevant technical records and documentation.	odgovornosti za obavljanje dotičnih zadataka. Savetovanje o tim detaljnim aranžmanima sprovodi se pre njihovog završetka sa fizičkim i pravnim licima na koje se preraspodela odnosi i, u slučaju preraspodele iz stava 2., sa Agencijom. U tim detaljnim aranžmanima jasno se utvrđuju barem zadaci koji se preraspodeljuju i navode se pravni, praktični i administrativni aranžmani potrebni za osiguravanje urednog prenosa i efikasnog i neprekinutog nastavka obavljanja dotičnih zadataka u skladu sa ovom Uredbom i delegiranim i sprovedbenim aktima donesenim na osnovu ove Uredbe, kao i nesmetanog nastavka aktivnosti koje preduzimaju dotična fizička i pravna lica. Detaljni aranžmani takođe uključuju odredbe o prenosu relevantnih tehničkih zapisa i dokumentacije.
Agjencia dhe Shteti Anëtar ose Shtetet Anëtare në fjalë, sipas rastit, sigurojnë që rialokimi i përgjegjësisë për detyrat të kryhet në përputhje me këto aranzhime të hollësishme.	The Agency and the Member State or Member States concerned, as applicable, shall ensure that the reallocation of the responsibility for the tasks is carried out in accordance with those detailed arrangements.	Agencija i dotična država članica ili dotične države članice, u zavisnosti od slučaja, osiguravaju da se preraspodela odgovornosti za obavljanje zadataka sprovede u skladu sa tim detaljnim aranžmanima.
6. Agjencia vë në dispozicion, nëpërmjet repozitorit të krijuar sipas nenit 74, një listë të Shteteve Anëtare që kanë aplikuar paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Kjo listë identifikon qartë detyrat e rialokuara dhe autoritetin kompetent përgjegjës për detyrat pas rialokimit të tyre.	6. The Agency shall make available, through the repository established under Article 74, a list of Member States that have applied paragraphs 1 and 2 of this Article. That list shall clearly identify the reallocated tasks and the competent authority responsible for the tasks after their reallocation.	6. Agencija u bazi podataka uspostavljenoj u skladu sa članom 74. stavlja na raspolaganje spisak država članica koje su primenile stavove 1. i 2. ovog člana. Na tom se spisku jasno navode preraspodeljeni zadaci i nadležno telo odgovorno za te zadatke nakon njihove preraspodele.

Agjencia merr parasysh rialokimin e përgjegjësisë për detyrat gjatë kryerjes së inspektimeve dhe aktiviteteve të tjera monitoruese në përputhje me nenin 85.	The Agency shall take account of the reallocation of the responsibility for the tasks when conducting inspections and other monitoring activities in accordance with Article 85.	Agencija uzima u obzir preraspodelu odgovornosti za zadatke pri obavljanju inspekcijskih pregleda i drugih aktivnosti praćenja u skladu sa članom 85.
7. Rialokimet e përgjegjësisë sipas këtij neni nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare sipas Konventës së Çikagos.	7. The reallocations of responsibility under this Article shall be without prejudice to the rights and obligations of the Member States under the Chicago Convention.	7. Preraspodelama odgovornosti u skladu sa ovim članom ne dovode se u pitanje prava i obaveze država članica u skladu sa Čikaškom konvencijom.
Kur një Shtet Anëtar rialokon, në përputhje me këtë nen, përgjegjësinë për detyrat që i janë atribuuar atij sipas Konventës së Çikagos, ai njofton ICAO-n rreth faktit se Agjencia ose një Shtet tjetër Anëtar kryen në emër të tij funksionet dhe detyrat e caktuara atij sipas Konventës së Çikagos.	When a Member State reallocates, in accordance with this Article, the responsibility for the tasks which are attributed to it by the Chicago Convention, it shall notify ICAO about the fact that the Agency or another Member State carries out on its behalf the functions and duties ascribed to it under the Chicago Convention.	Kada država članica u skladu sa ovim članom preraspodeli odgovornost za zadatke koji su joj dodeljeni u skladu sa Čikaškom konvencijom, ona obaveštava IACO o tome da Agencija ili druga država članica u njeno ime obavlja funkcije i dužnosti koje su joj dodeljene u skladu sa Čikaškom konvencijom.
8. Një Shtet Anëtar që ka rialokuar përgjegjësinë për detyrat tek Agjencia ose një Shtet tjetër Anëtar në pajtim me paragrafin 1 ose 2, mund, në çdo kohë, të vendosë të anulojë rialokimin. Në këtë rast, paragrafët 4, 5, 6 dhe nënparagrafi i dytë i paragrafit 7 aplikohen mutatis mutandis.	8. A Member State which has reallocated the responsibility for the tasks to the Agency or another Member State pursuant to paragraph 1 or 2, may, at any time, decide to revoke the reallocation. In that case, paragraphs 4, 5, 6 and the second subparagraph of paragraph 7 shall apply mutatis mutandis.	8. Država članica koja je preraspodelila odgovornost za zadatke Agenciji ili drugoj državi članici na osnovu stava 1. ili stava 2. može u svakom trenutku odlučiti da ukine preraspodelu. U tom slučaju primenjuju se, mutatis mutandis, stavovi 4., 5. i 6. i stav 7. drugi podstav.
Neni 65 **Rialokimi i përgjegjësisë sipas kërkesës së organizatave që operojnë në më shumë se një Shtet Anëtar**	**Article 65** **Reallocation of responsibility upon request of organisations operating in more than one Member State**	**Član 65** **Preraspodela odgovornosti na zahtev organizacija koje deluju u više država članica**
1. Një organizatë mund të kërkojë që Agjencia të veprojë si autoriteti kompetent përgjegjës për detyrat që lidhen me certifikimin, mbikëqyrjen dhe	1. An organisation may request that the Agency acts as the competent authority responsible for the tasks related to certification, oversight and	1. Odstupajući od člana 62. stava 4. organizacija može zatražiti da Agencija deluje kao nadležno telo odgovorno za zadatke u vezi sa

zbatimin në lidhje me atë organizatë, nëpërmjet derogimit nga neni 62 (4), kur ajo organizatë mban një certifikatë ose ka të drejtën për të aplikuar për një certifikatë në përputhje me Kapitullin III tek autoriteti kompetent kombëtar nga një Shtet Anëtar, por ka ose synon të ketë një pjesë të konsiderueshme të objekteve dhe personelit të mbuluar nga ajo certifikatë të vendosur në një ose më shumë Shtete të tjera Anëtare.	enforcement with respect to that organisation, by way of derogation from Article 62(4), where that organisation holds a certificate or is eligible to apply for a certificate in accordance with Chapter III to the national competent authority from one Member State, but it has or it intends to have a substantial proportion of facilities and personnel covered by that certificate located in one or more other Member States.	sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa s obzirom na tu organizaciju ako ta organizacija ima sertifikat ili ima pravo na podnošenje zahteva za izdavanje sertifikata u skladu sa poglavljem III nacionalnom nadležnom telu iz jedne države članice, ali ima ili namerava da ima znatan deo objekata i osoblja obuhvaćenih tim sertifikatom u jednoj ili više drugih država članica.
Një kërkesë e tillë mund të bëhet edhe nga dy ose më shumë organizata që janë pjesë e një grupimi të vetëm biznesi, secila prej të cilave ka një vend kryesor të biznesit në një Shtet Anëtar të ndryshëm dhe secila prej të cilave mban një certifikatë ose ka të drejtë të aplikojë për një certifikatë në përputhje me Kapitullin III për të njëjtin lloj të aktivitetit të aviacionit.	Such a request may also be made by two or more organisations forming part of a single business grouping, each of which has a principal place of business in a different Member State and each of which holds a certificate or is eligible to apply for a certificate in accordance with Chapter III for the same type of aviation activity.	Takav zahtev takođe mogu podneti dve organizacije ili više njih koje pripadaju istoj poslovnoj grupaciji, pri čemu svaka od njih ima glavno mesto poslovanja u različitoj državi članici i svaka od njih ima sertifikat ili ima pravo na podnošenje zahteva za izdavanje sertifikata u skladu sa poglavljem III za istu vrstu aktivnosti u vazduhoplovstvu.
2. Kërkesa e referuar në paragrafin 1 dërgohet nga organizatat përkatëse tek Agjencia dhe autoritetet kombëtare kompetente të Shteteve Anëtare, në të cilat ato kanë vendet e tyre kryesore të biznesit.	2. The request referred to in paragraph 1 shall be sent by the organisations concerned to the Agency and the national competent authorities of the Member States in which they have their principal places of business.	2. Zahtev iz stava 1. dotične organizacije šalju Agenciji i nadležnim nacionalnim telima država članica u kojima imaju glavna mesta poslovanja.
Pas pranimit të kësaj kërkese, Agjencia dhe autoritetet përkatëse kompetente kombëtare, pa vonesa të panevojshme, konsultohen me njëra-tjetrën dhe, nëse është e nevojshme, kërkojnë mendime shtesë nga organizatat që kanë bërë kërkesën. Në këto konsultime, Agjencia dhe autoritetet kompetente kombëtare shqyrtojnë përdorimin e inspektorëve dhe të personelit tjetër në dispozicion të autoriteteve përkatëse kompetente	Upon receipt of that request, the Agency and the national competent authorities concerned shall, without undue delay, consult each other and, if needed, seek supplementary views from the organisations that made the request. In those consultations consideration shall be given by the Agency and by the national competent authorities to making use of inspectors and of other personnel available to the national competent authorities	Nakon prijema tog zahteva Agencija i dotična nacionalna nadležna tela bez odlaganja se međusobno savetuju i ako je to potrebno traže dodatne tačke gledišta od organizacija koje su podnele zahtev. U tim savetovanjima Agencija i nacionalna nadležna tela razmatraju da li će se u slučaju dogovora o preraspodeli angažovati inspektore i drugo osoblje dostupno dotičnim nacionalnim nadležnim telima.

kombëtare në rast të një marrëveshjeje mbi rialokimin.	concerned in the case of an agreement on reallocation.	
Nëse, pas këtyre konsultimeve, Agjencia ose një autoritet përkatës kompetent kombëtar konsideron se kërkesa do të kishte një efekt të pafavorshëm në vetë aftësinë e tij për të kryer në mënyrë efektive detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit sipas kësaj Rregulloreje dhe sipas akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, ose do të ndikonte negativisht në funksionimin efektiv të autoritetit, ajo, brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh nga data e marrjes së asaj kërkese, informon organizatat përkatëse se konsideron se kërkesa do të kishte efekt të tillë të pafavorshëm, duke ofruar arsyetimin. Kjo letër informacioni gjithashtu i komunikohet palës tjetër. Në këtë rast, kërkesa konsiderohet të jetë hedhur poshtë.	If, following those consultations, the Agency or a national competent authority concerned considers that the request would have an adverse effect on its own ability to effectively conduct certification, oversight and enforcement tasks under this Regulation and under the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, or would otherwise adversely impact the effective functioning of the authority it shall, within a maximum period of 180 days from the date of receipt of that request, inform the organisations concerned that it considers that the request would have such adverse effect, providing its justification. That letter of information shall also be communicated to the other party. In that case, the request shall be considered to have been dismissed.	Ako nakon tih savetovanja Agencija ili dotično nacionalno nadležno telo smatra da bi zahtev imao negativan uticaj na njihovu sposobnost efikasnog obavljanja zadataka u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa u skladu sa ovom Uredbom i delegiranim i sprovedbenim aktima donesenim na osnovu ove Uredbe ili bi na neki drugi način negativno uticao na efikasno funkcionisanje tela, Agencija ili dotično nadležno nacionalno telo u roku od najviše 180 dana od dana prijema tog zahteva obaveštava dotične organizacije o tome zbog čega smatra da bi zahtev imao takav negativan uticaj, uz navođenje obrazloženja. Taj dopis sa informacijama šalje se i drugoj strani. U tom se slučaju smatra da je zahtev odbijen.
3. Përveç nëse kërkesa është hedhur poshtë në përputhje me paragrafin 2, Agjencia dhe autoritetet përkatëse kompetente kombëtare hyjnë në aranzhime të hollësishme lidhur me rialokimin e përgjegjësisë për detyrat përkatëse. Organizatat që kanë kërkuar nga Agjencia që të veprojë si autoriteti i tyre kompetent, konsultohen rreth atyre aranzhimeve të hollësishme para se ato të finalizohen. Këto aranzhime të hollësishme, të paktën, identifikojnë qartë detyrat që janë duke u rialokuar, dhe përfshijnë aranzhimet ligjore, praktike dhe administrative të nevojshme për të siguruar një transferim të rregullt, dhe vazhdimin efektiv dhe të pandërprerë të kryerjes së detyrave në fjalë, në përputhje me këtë Rregullore dhe me aktet	3. Unless the request has been dismissed in accordance with paragraph 2, the Agency and the national competent authorities concerned shall conclude detailed arrangements concerning the reallocation of responsibility for the tasks concerned. The organisations that requested the Agency to act as their competent authority shall be consulted on those detailed arrangements before they are finalised. Those detailed arrangements shall, at least, identify clearly the tasks which are being reallocated, and shall include the legal, practical and administrative arrangements necessary for ensuring an orderly transfer, and the effective and uninterrupted continuation of the	3. Osim ako je zahtev odbijen u skladu sa stavom 2., Agencija i dotična nacionalna nadležna tela sklapaju detaljne aranžmane u vezi sa preraspodelom odgovornosti za dotične zadatke. Savetovanje o tim detaljnim aranžmanima sprovodi se pre njihovog završetka sa organizacijama koje su zatražile od Agencija da deluje kao njihovo nadležno telo. U tim detaljnim aranžmanima jasno se utvrđuju barem zadaci koji se preraspodeljuju te se u njima navode pravni, praktični i administrativni aranžmani potrebni za osiguravanje urednog prenosa i efikasnog i neprekinutog nastavka obavljanja dotičnih zadataka u skladu sa ovom Uredbom i delegiranim i sprovedbenim aktima

e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, si dhe një vazhdimësi të patëmetë të aktiviteteve të ndërmarra nga organizatat përkatëse. Aranzhimet e hollësishme gjithashtu përfshijnë dispozita mbi transferimin e dokumenteve dhe shënimeve relevante teknike.	performance of the tasks concerned, in compliance with this Regulation and with the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, as well as a seamless continuation of the activities undertaken by the organisations concerned. The detailed arrangements shall also include provisions on the transfer of relevant technical records and documentation.	donesenim na osnovu ove Uredbe, kao i nesmetanog nastavka aktivnosti koje preduzimaju dotične organizacije. Detaljni aranžmani takođe uključuju odredbe o prenosu relevantnih tehničkih zapisa i dokumentacije.
Agjencia dhe Shteti Anëtar ose Shtetet Anëtare përkatëse, sipas rastit, sigurojnë që rialokimi i përgjegjësisë për detyrat kryhet në përputhje me ato aranzhime të hollësishme. Gjatë zbatimit të këtyre aranzhimeve, Agjencia përdorë deri në masën e mundshme inspektorët dhe personelin tjetër në dispozicion në Shtetet Anëtare.	The Agency and the Member State or Member States concerned, as applicable, shall ensure that the reallocation of the responsibility for the tasks is carried out in accordance with those detailed arrangements. When implementing those arrangements, the Agency shall use to the extent possible the inspectors and other personnel available in the Member States.	Agencija i dotična država članica ili dotične države članice, u zavisnosti od slučaja, osiguravaju da se preraspodela odgovornosti za obavljanje zadataka sprovodi u skladu sa tim detaljnim aranžmanima. Prilikom sprovođenja tih aranžmana Agencija se u najvećoj mogućoj meri koristi uslugama inspektora i drugog osoblja dostupnog u državama članicama.
4. Pas hyrjes në aranzhimet e hollësishme sipas paragrafit 3, Agjencia bëhet autoriteti kompetent përgjegjës për detyrat e mbuluara nga kërkesa dhe Shteti Anëtar ose Shtetet Anëtare përkatëse lirohen nga përgjegjësia për këto detyra. Në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë për detyrat e rialokuara nga Agjencia, zbatohen Kapitujt IV dhe V.	4. Upon the conclusion of the detailed arrangements pursuant to paragraph 3, the Agency shall become the competent authority responsible for the tasks covered by the request and the Member State or Member States concerned shall be relieved of the responsibility for those tasks. In relation to the exercise of the responsibility for the reallocated tasks by the Agency, Chapters IV and V shall apply.	4. Nakon sklapanja detaljnih aranžmana na osnovu stava 3. Agencija postaje nadležno telo odgovorno za zadatke obuhvaćene zahtevom, a prestaje odgovornost za navedene zadatke dotične države članice ili dotičnih država članica. U vezi sa ispunjavanjem odgovornosti za preraspodeljene zadatke od strane Agencije primenjuju se poglavlja IV i V.
5. Neni 64 (3), (6) dhe (7) zbatohen mutatis mutandis për çdo rialokim të përgjegjësisë për detyrat sipas këtij neni.	5. Article 64(3), (6) and (7) shall apply mutatis mutandis to any reallocation of responsibility for the tasks pursuant to this Article.	5. Član 64. stavovi 3., 6. i 7. primenjuju se, mutatis mutandis, na svaku preraspodelu odgovornosti za zadatke na osnovu ovog člana.
6. Organizatat në lidhje me të cilat Agjencia vepron si një autoritet kompetent sipas këtij neni, mund të kërkojë që Shtetet Anëtare ku ato	6. Organisations in respect of which the Agency acts as a competent authority pursuant to this Article may request that the Member States	6. Organizacije u pogledu kojih Agencija deluje kao nadležno telo na osnovu ovog člana mogu zatražiti da države članice u kojima se nalaze

organizata kanë vendet e tyre kryesore të biznesit të marrin përgjegjësitë për detyrat që lidhen me certifikimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin në lidhje me ato organizata. Në këtë rast, nenet 64 (4) deri në (7) zbatohen mutatis mutandis.	where those organisations have their principal places of business resume responsibility for the tasks related to certification, oversight and enforcement with respect to those organisations. In that case, Articles 64(4) to (7) shall apply mutatis mutandis.	glavna mesta poslovanja tih organizacija ponovno preuzmu odgovornost za obavljanje zadataka u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa u odnosu na te organizacije. U tom slučaju primenjuju se, mutatis mutandis, član 64. stavovi od 4. do 7.
Neni 66 **Mekanizmi mbështetës i mbikëqyrjes**	**Article 66** **Oversight support mechanism**	**Član 66** **Mehanizam podrške nadzora**
1. Kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:	1. Where all of the following conditions have been met:	1. Ako su ispunjeni svi sledeći uslovi:
(a) rezultatet e inspektimeve dhe aktiviteteve të tjera monitoruese të kryera nga Agjencia në pajtim me nenin 85 tregojnë një paaftësi serioze dhe të vazhdueshme të një Shteti Anëtar për të kryer në mënyrë efektive disa ose të gjitha detyrat e tij të certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit sipas kësaj Rregulloreje;	(a) the results of inspections and other monitoring activities conducted by the Agency in accordance with Article 85 indicate a serious and persisting inability of a Member State to effectively perform certain or all of its certification, oversight and enforcement tasks under this Regulation;	(a) rezultati inspekcijskih pregleda i drugih aktivnosti praćenja koje Agencija sprovodi na osnovu člana 85. ukazuju na ozbiljnu i trajnu nesposobnost države članice da efikasno obavlja pojedine ili sve svoje zadatke u vezi sa zadacima sertifikacije, nadzora i osiguravanjem sprovođenja propisa u skladu sa ovom Uredbom;
(b) Komisioni ka kërkuar nga Shteti Anëtar përkatës që të korrigjojë mangësitë e identifikuara në përputhje me pikën (a);	(b) the Commission has requested the Member State concerned to remedy the deficiencies identified in accordance with point (a);	(b) Komisija je od dotične države članice zatražila otklanjanje nedostataka utvrđenih u skladu sa tačkom (a);
(c) Shteti Anëtar nuk i ka korrigjuar mangësitë në mënyrë të kënaqshme dhe situata rezultuese e rrezikon sigurinë e aviacionit civil,	(c) the Member State has not remedied the deficiencies in a satisfactory manner and the resulting situation endangers civil aviation safety,	(c) država članica nije otklonila nedostatke na zadovoljavajući način i situacija koja iz toga proizlazi ugrožava bezbednost civilnog vazduhoplovstva,
Shteti Anëtar përkatës dhe Agjencia, me kërkesën e Komisionit, krijojnë bashkërisht një program të përkohshëm të asistencës teknike me qëllim të	the Member State concerned and the Agency shall, at the request of the Commission, establish jointly a temporary technical assistance programme with	dotična država članica i Agencija na zahtev Komisije zajednički uspostavljaju privremeni program tehničke pomoći sa ciljem otklanjanja

korrigjimit të mangësive të identifikuara dhe ofrimit të ndihmës Shtetit Anëtar përkatës për të rikthyer aftësinë e tij për të kryer detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të mbuluara nga kjo rregullore deri në fund të fazës mbështetëse. Ky program i asistencës teknike përfshin, në veçanti, afatin kohor të programit, planifikimin dhe ushtrimin e detyrave të certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit në rastet kur janë identifikuar defekte, trajnimin dhe kualifikimet e inspektorëve dhe personelit përkatës, si dhe organizimin e punës së autoritetit kompetent kombëtar të Shtetit Anëtar përkatës, kur kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në mangësitë e identifikuara.	the aim of remedying the identified deficiencies and assisting the Member State concerned to restore its ability to perform the certification, oversight and enforcement tasks covered by this Regulation by the end of the support phase. That technical assistance programme shall include, in particular, the timeline of the programme, the planning and exercise of certification, oversight and enforcement tasks in cases where deficiencies have been identified, the training and qualifications of relevant inspectors and personnel, and the organisation of the work of the national competent authority of the Member State concerned, where it has direct influence on the identified deficiencies.	utvrđenih nedostataka i pružanja pomoći dotičnoj državi članici da do kraja faze podrške povrati sposobnost obavljanja zadataka u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa obuhvaćenih ovom Uredbom. Taj program tehničke pomoći posebno uključuje vremenski raspored programa, planiranje i obavljanje zadataka u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa u slučajevima kada su utvrđeni nedostaci, osposobljavanje i osposobljenost relevantnih inspektora i osoblja i organizaciju rada nacionalnog nadležnog tela dotične države članice ako to ima direktan uticaj na utvrđene nedostatke.
2. Shteti Anëtar përkatës është përgjegjës për zbatimin e programit të asistencës teknike për të korrigjuar mangësitë e identifikuara. Për këtë qëllim, shteti anëtar përkatës bashkëpunon me Agjencinë kur zbaton këtë program të asistencës teknike, duke përfshirë nëpërmjet dhënies së të gjitha udhëzimeve të nevojshme autoritetit kompetent kombëtar dhe sigurimin e të gjitha strukturave materiale të nevojshme për realizimin e suksesshëm të programit të asistencës.	2. The Member State concerned shall be responsible for the implementation of the technical assistance programme to remedy the identified deficiencies. For that purpose, the Member State concerned shall cooperate with the Agency when implementing that technical assistance programme, including by issuing all necessary instructions to the national competent authority and providing all material facilities necessary for the successful conduct of the assistance programme.	2. Dotična država članica odgovorna je za sprovođenje programa tehničke pomoći za otklanjanje utvrđenih nedostataka. U tu svrhu dotična država članica sarađuje sa Agencijom pri sprovođenju tog programa tehničke pomoći, između ostalog i izdavanjem svih potrebnih uputstava nacionalnom nadležnom telu i pružanjem svih materijalnih sredstava potrebnih za uspešno sprovođenje programa pomoći.
Gjatë zbatimit të programit të asistencës teknike, Shteti Anëtar përkatës mbetet përgjegjës për detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit, në përputhje me Nenin 62 (2). Agjencia bartë vetë shpenzimet e veta kur ofron asistencë për Shtetin Anëtar në fjalë.	During the implementation of the technical assistance programme, the Member State concerned shall remain responsible for the certification, oversight and enforcement tasks, in accordance with Article 62(2). The Agency shall bear its own costs when providing assistance to the Member State concerned.	Tokom sprovođenja programa tehničke pomoći dotična država članica i dalje je odgovorna za zadatke u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa, u skladu sa članom 62. stavom 2. Agencija snosi svoje troškove kada pruža pomoć dotičnoj državi članici.

Gjatë zbatimit të programit të asistencës teknike, shteti anëtar përkatës, nëse është e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e mangësive, shfrytëzon grupin e inspektorëve evropian të aviacionit të themeluar sipas nenit 63, të subjekteve të kualifikuara sipas nenit 69, si dhe mundësitë e trajnimit të parashikuara në nenin 92.	When implementing the technical assistance programme, the Member State concerned shall, if appropriate, given the nature of the deficiencies, make use of the pool of European aviation inspectors established under Article 63, of the qualified entities under Article 69, and of the training possibilities envisaged under Article 92.	Kada sprovodi program tehničke pomoći dotična država članica, prema potrebi i s obzirom na prirodu nedostataka, koristi se grupom evropskih vazduhoplovnih inspektora uspostavljenom u skladu sa članom 63., kvalifikovanim subjektima iz člana 69. i mogućnostima osposobljavanja predviđenim u skladu sa članom 92.
3. Agjencia ofron informacione të përditësuara për Komisionin dhe shtetet e tjera anëtare mbi progresin e bërë në zbatimin e programit të asistencës teknike.	3. The Agency shall provide updates to the Commission and the other Member States on the progress made in the implementation of the technical assistance programme.	3. Agencija Komisiji i ostalim državama članicama dostavlja nove informacije o napretku ostvarenom u primeni programa tehničke pomoći.
4. Shteti Anëtar përkatës bën të gjitha përpjekjet e mundshme për të rivendosur aftësinë e tij për të kryer detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit sipas kësaj Rregulloreje. Nëse Shteti Anëtar përkatës pranon që programi i mbështetjes teknike nuk mund të zbatohet siç është planifikuar, ai informon Komisionin për këtë dhe rialokon përgjegjësitë e tij për detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit tek Agjencia ose tek një Shtet tjetër Anëtar në përputhje me Nenin 64 ose merr masa të tjera për të zgjidhur mangësitë. Fushëveprimi i rialokimit kufizohet në atë që është rreptësishtë e nevojshme për të adresuar mangësitë e identifikuara. Agjencia përfshin në repozitorin e krijuar sipas nenit 74 informacionin rreth detyrave që janë rialokuar dhe e bën publik këtë informacion.	4. The Member State concerned shall make all possible efforts to restore its ability to perform certification, oversight and enforcement tasks under this Regulation. If the Member State concerned recognises that the technical support programme cannot be implemented as planned, it shall inform the Commission thereof and shall either reallocate its responsibilities for certification, oversight and enforcement tasks to the Agency or to another Member State in accordance with Article 64 or take other measures to resolve the deficiencies. The scope of the reallocation shall be limited to what is strictly necessary in order to address the deficiencies identified. The Agency shall include in the repository established under Article 74 the information about the tasks that have been reallocated and shall make that information public.	4. Dotična država članica ulaže sve moguće napore kako bi povratila svoju sposobnost obavljanja zadataka u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa u skladu sa ovom Uredbom. Ako dotična država članica utvrdi da se program tehničke pomoći ne može sprovesti prema planu, o tome obaveštava Komisiju i preraspodeljuje svoje odgovornosti za zadatke u vezi sa sertifikacijom, nadzorom i osiguravanjem sprovođenja propisa Agenciji ili drugoj državi članici u skladu sa članom 64. ili preduzima druge mere za rešavanje nedostataka. Raspon preraspodele ograničen je na ono što je neophodno za rešavanje utvrđenih nedostataka. Agencija u bazu podataka uspostavljenu u skladu sa članom 74. uključuje informacije o preraspodeljenim zadacima i te informacije objavljuje.

5. Ky nen nuk cenon zbatimin e masave të tjera, përfshirë nenin 67 të kësaj Rregulloreje dhe Rregulloren nr. 10/2015 të AAC.	5. This Article shall be without prejudice to the application of other measures, including Article 67 of this Regulation and CAA Regulation No 10/2015.	5. Ovim članom ne dovodi se u pitanje primena drugih mera, uključujući član 67. ove Uredbe i Uredbu ACV-a br. 10/2015.
Neni 67 **Vlefshmëria dhe njohja e certifikatave dhe deklaratave**	**Article 67** **Validity and recognition of certificates and declarations**	**Član 67** **Valjanost i priznavanje sertifikata i izjava**
1. Certifikatat e lëshuara nga Agjencia ose autoritetet kompetente kombëtare dhe deklarimet e bëra nga personat fizik dhe juridik në përputhje me këtë Rregullore dhe me aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, i nënshtrohen ekskluzivisht rregullave, kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe kërkesave administrative kombëtare dhe janë të vlefshme dhe të njohura në të gjitha Shtetet Anëtare, pa kërkesa ose vlerësime të mëtejshme.	1. Certificates issued by the Agency or the national competent authorities, and declarations made by natural and legal persons in accordance with this Regulation and with the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof shall be subject exclusively to the rules, conditions and procedures laid down in this Regulation and national administrative requirements and shall be valid and recognised in all Member States, without further requirements or evaluation.	1. Sertifikati koje izdaje Agencija ili nacionalna nadležna tela i izjave koje su dala fizička i pravna lica u skladu sa ovom Uredbom i delegiranim i sprovedbenim aktima donesenim na osnovu ove Uredbe podležu isključivo pravilima, uslovima i postupcima utvrđenim u ovoj Uredbi i nacionalnim administrativnim zahtevima, valjani su i priznaju se u svim državama članicama bez daljih zahteva ili evaluacije.
2. Nëse Komisioni konsideron se një person juridik ose fizik, të cilit i është lëshuar një certifikatë ose që ka bërë një deklaratë, nuk është më në përputhje me kushtet e zbatueshme të kësaj Rregulloreje, ose akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, Komisioni, bazuar në rekomandimin nga Agjencia, kërkon nga shteti anëtar përgjegjës për mbikëqyrjen e atij personi të ndërmarrë veprime korrigjuese dhe masat mbrojtëse të përshtatshme, përfshirë edhe kufizimin ose pezullimin e certifikatës. Komisioni miraton aktet zbatuese që përmbajnë atë vendim. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën	2. If the Commission considers that a legal or a natural person to which a certificate has been issued or which has made a declaration no longer complies with the applicable requirements of this Regulation or of the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, the Commission shall, based on a recommendation from the Agency, require the Member State responsible for the oversight of that person to take appropriate corrective action and safeguard measures, including limitation or suspension of the certificate. The Commission shall adopt implementing acts containing that	2. Ako Komisija smatra da pravno ili fizičko lice kome je izdat sertifikat ili koje je dalo izjavu više ne poštuje primenjive zahteve ove Uredbe ili delegiranih i sprovedbenih akata donesenih na osnovu ove Uredbe, Komisija na osnovu preporuke Agencije od države članice odgovorne za nadzor i lica zahteva preduzimanje odgovarajućih korektivnih i zaštitnih mera, uključujući ograničavanje ili privremeno oduzimanje sertifikata. Komisija donosi sprovedbene akte koji sadrže tu odluku. Ti se sprovedbeni akti donose u skladu sa savetodavnim postupkom iz člana 127. stava 2.

këshillimore të përmendur në nenin 127 (2). Mbi baza të justifikuara imperative të urgjencës lidhur me sigurinë e aviacionit, Komisioni menjëherë miraton aktet zbatuese të aplikueshme, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 127 (4).	decision. Those implementing acts shall be adopted in accordance with the advisory procedure referred to in Article 127(2). On duly justified imperative grounds of urgency relating to aviation safety, the Commission shall adopt immediately applicable implementing acts in accordance with the procedure referred to in Article 127(4).	Zbog opravdanih krajnje hitnih razloga koji se odnose na bezbednost vazdušnog saobraćaja Komisija u skladu sa postupkom iz člana 127. stava 4. donosi odmah primenjive sprovedbene akte.
Nga data kur ai akt zbatues hyn në fuqi, certifikata ose deklarata në fjalë, nëpërmjet derogimit nga paragrafi 1, nuk do të jetë më e vlefshme dhe e njohur në të gjitha Shtetet Anëtare.	From the date at which that implementing act takes effect, the certificate or declaration concerned shall, by way of derogation from paragraph 1, no longer be valid and recognised in all Member States.	Od datuma od kojeg taj sprovedbeni akt počne proizvoditi efekte, dotični sertifikat ili dotična izjava, odstupajući od stava 1., više nisu valjani niti se priznaju u svim državama članicama.
3. Kur Komisioni konsideron që Shteti Anëtar i përmendur në paragrafin 2 ka ndërmarrë veprimet e duhura korrigjuese dhe masat mbrojtëse, ai vendos, bazuar në rekomandimin e Agjencisë, se certifikata ose deklarata në fjalë përsëri është e vlefshme dhe e njohur në të gjitha Shtetet Anëtare, në pajtim me paragrafin 1.	3. When the Commission considers that the Member State referred to in paragraph 2 has taken appropriate corrective action and safeguard measures, it shall decide, based on a recommendation from the Agency, that the certificate or declaration concerned shall again be valid and recognised in all Member States, in accordance with paragraph 1.	3. Kada Komisija smatra da je država članica iz stava 2. preduzela odgovarajuće korektivne i zaštitne mere, na osnovu preporuke Agencije odlučuje da su dotični sertifikat ili dotična izjava ponovno valjani i da se priznaju u svim državama članicama u skladu sa stavom 1.
Komisioni miraton aktet zbatuese që përmbajnë atë vendim. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën këshillimore të përmendur në nenin 127 (2). Mbi baza të justifikuara imperative të urgjencës lidhur me sigurinë e aviacionit, Komisioni menjëherë miraton aktet zbatuese të aplikueshme, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 127 (4).	The Commission shall adopt implementing acts containing that decision. Those implementing acts shall be adopted in accordance with the advisory procedure referred to in Article 127(2). On duly justified imperative grounds of urgency relating to aviation safety, the Commission shall adopt immediately applicable implementing acts in accordance with the procedure referred to in Article 127(4).	Komisija donosi sprovedbene akte koji sadrže tu odluku. Ti se sprovedbeni akti donose u skladu sa savetodavnim postupkom iz člana 127. stava 2. Zbog opravdanih krajnje hitnih razloga koji se odnose na bezbednost vazdušnog saobraćaja Komisija u skladu sa postupkom iz člana 127. stava 4. donosi odmah primenjive sprovedbene akte.

4. Ky nen nuk cenon Rregulloren nr. 10/2015 të AAC.	4. This Article shall be without prejudice to CAA Regulation No 10/2015.	4. Ovim se članom ne dovodi u pitanje Uredba ACV-a br. 10/2015.
Neni 68 **Pranimi i certifikimit nga vendet e treta**	**Article 68** **Acceptance of third-country certification**	**Član 68** **Priznavanje sertifikata trećih zemalja**
1. Agjencia dhe autoritetet kompetente kombëtare mund të lëshojnë certifikatat e parashikuara në këtë rregullore dhe në aktet e deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, në bazë të certifikatave të lëshuara në përputhje me ligjet e një vendi të tretë, ose të pranojnë certifikata dhe dokumente të tjera relevante që vërtetojnë përputhshmërinë me rregullat e aviacionit civil të cilat janë lëshuar në përputhje me ligjet e një vendi të tretë, kur një mundësi e tillë është parashikuar në:	1. The Agency and the national competent authorities may either issue the certificates provided for in this Regulation, and in the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, on the basis of certificates issued in accordance with the laws of a third country, or accept certificates and other relevant documentation attesting compliance with civil aviation rules which were issued in accordance with the laws of a third country, where such possibility is provided for in:	1. Agencija i nacionalna nadležna tela mogu izdavati sertifikate predviđene u ovoj Uredbi i u delegiranim i sprovedbenim aktima donesenim na osnovu ove Uredbe na osnovu sertifikata koji su izdati u skladu sa propisima treće zemlje, ili mogu priznavati sertifikate i drugu odgovarajuću dokumentaciju kojom se potvrđuje usklađenost sa pravilima u području civilnog vazduhoplovstva, a koji su izdati u skladu sa propisima treće zemlje, ako je takva mogućnost predviđena u:
(a) marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me njohjen e certifikatave të lidhura ndërmjet Unionit dhe një vendi të tretë;	(a) international agreements concerning the recognition of certificates concluded between the Union and a third country;	(a) međunarodnim sporazumima o priznavanju sertifikata sklopljenim između Unije i treće zemlje;
(b) aktet e deleguara të miratuara në bazë të paragrafit 3; ose	(b) the delegated acts adopted on the basis of paragraph 3; or	(b) delegiranim aktima donesenim na osnovu stava 3; ili
(c) në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe të një akti të deleguar përkatës, siç përmendet në pikat (a) respektivisht (b) të këtij paragrafi, dhe pa cenuar nenin 136 (6) të kësaj Rregulloreje, një marrëveshje lidhur me njohjen e certifikatave të lidhura ndërmjet një Shteti Anëtar dhe një vendi të tretë që i është njoftuar Komisionit	(c) in the absence of an international agreement and of a relevant delegated act as referred to in points (a) and (b) of this paragraph respectively, and without prejudice to Article 136(6) of this Regulation, an agreement concerning the recognition of certificates concluded between a Member State and a third country that has been	(c) ako ne postoje međunarodni sporazum i relevantni delegirani akti iz tačke (a) odnosno tačke (b) ovog stava i ne dovodeći u pitanje član 136. stav 6. ove Uredbe, sporazum o priznavanju sertifikata zaključen između države članice i treće zemlje o kojem su Komisija i ostale države

dhe Shteteve të tjera Anëtare në përputhje me pikën (a) të Nenit 12 (2) të Rregullores nr. 3/2009 të AAC.	notified to the Commission and the other Member States in accordance with point (a) of Article 12(2) of CAA Regulation No. 3/2009.	članice obaveštene u skladu sa tačkom (a) člana 12 stav 2. Uredbe ACV-a br. 3/2009.
2. Për të arritur dhe ruajtur besimin në sistemet rregullatore të vendeve të treta, Agjencia autorizohet të kryejë vlerësimet e nevojshme teknike dhe vlerësimet e ligjeve të vendeve të treta dhe të autoriteteve të huaja të aviacionit. Për qëllime të kryerjes së vlerësimeve të tilla, Agjencia mund të hyjë në aranzhime të punës në përputhje me nenin 90 (2.	2. In order to achieve and maintain confidence in the regulatory systems of third countries, the Agency shall be authorised to conduct the necessary technical assessments and evaluations of the laws of third countries and of foreign aviation authorities. For the purpose of conducting such assessments and evaluations, the Agency may conclude working arrangements in accordance with Article 90(2).	2. Kako bi se ostvarilo i održalo poverenje u regulatorne sisteme trećih zemalja, Agencija je ovlašćena da sprovodi potrebne tehničke procene i evaluacije propisa trećih zemalja i stranih vazduhoplovnih tela. U svrhu sprovođenja takvih procena i evaluacija Agencija može sklapati radne aranžmane u skladu sa članom 90. stavom 2.
3. Komisioni është i autorizuar të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 128 që përcaktojnë rregullat e hollësishme në lidhje me pranimin e certifikatave dhe dokumentacionit tjetër që vërteton përputhjen me rregullat e aviacionit civil të lëshuara në përputhje me ligjet e një vendi të tretë dhe siguron një nivel ekuivalent të sigurisë me atë të parashikuar në këtë Rregullore, duke përfshirë kushtet dhe procedurat për arritjen dhe ruajtjen e besimit të nevojshëm në sistemet rregullative të vendeve të treta.	3. The Commission is empowered to adopt delegated acts in accordance with Article 128 laying down detailed rules with regard to the acceptance of certificates and other documentation attesting to compliance with civil aviation rules issued in accordance with the laws of a third country and ensuring an equivalent level of safety to that provided for in this Regulation, including the conditions and procedures for achieving and maintaining the necessary confidence in regulatory systems of third countries.	3. Komisija je ovlašćena za donošenje delegiranih akata u skladu sa članom 128. kojima se utvrđuju detaljna pravila u pogledu priznavanja sertifikata i druge dokumentacije kojom se potvrđuje usklađenost sa pravilima u području civilnog vazduhoplovstva, a koji su izdati u skladu sa propisima treće zemlje, i osigurava nivo bezbednosti koji je ekvivalentan onom koji je predviđen u ovoj Uredbi, između ostalog uslovi i postupci za ostvarivanje i održavanje potrebnog poverenja u regulatorne sisteme trećih zemalja.
Neni 69 **Subjektet e kualifikuara**	**Article 69** **Qualified entities**	**Član 69** **Kvalifikovani subjekti**
1. Agjencia dhe autoritetet kompetente kombëtare mund të alokojnë detyrat e tyre lidhur me certifikimin dhe mbikëqyrjen sipas kësaj	1. The Agency and the national competent authorities may allocate their tasks related to certification and oversight under this	1. Agencija i nacionalna nadležna tela svoje zadatke u vezi sa sertifikacijom i nadzorom iz ove Uredbe mogu dodeliti kvalifikovanim

rregulloreje tek subjektet e kualifikuara që janë akredituar në përputhje me aktet e deleguara të referuara në pikën (f) të nenit 62 (13) ose aktet zbatuese të përmendura në pikën (e) të nënparagrafit të parë të nenit 62 (14), si të pajtueshme me kriteret e përcaktuara në shtojcën VI.	Regulation to qualified entities that have been accredited in accordance with the delegated acts referred to in point (f) of Article 62(13) or the implementing acts referred to in point (e) of the first subparagraph of Article 62(14) as being compliant with the criteria set out in Annex VI.	subjektima koji su u skladu sa delegiranim aktima iz člana 62. stava 13. tačke (f) ili sprovedbenim aktima iz člana 62. stava 14. prvog podstava tačke (e) akreditovani kao usklađeni sa kriterijumima navedenim u Aneksu VI.
9. Komisioni miraton akte zbatuese që përcaktojnë rregullat e detajuara për metodat e punës të Agjencisë për kryerjen e detyrave sipas këtij neni. Këto akte zbatuese miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të referuar në nenin 127(3).	9. The Commission shall adopt implementing acts laying down detailed rules on the working methods of the Agency for conducting the tasks under this Article. Those implementing acts shall be adopted in accordance with the examination procedure referred to in Article 127(3).	9. Komisija donosi sprovedbene akte kojima se utvrđuju detaljna pravila o metodama rada Agencije za obavljanje zadataka u skladu sa ovim članom. Ti se sprovedbeni akti donose u skladu sa postupkom ispitivanja iz člana 127. stava 3.

Neni 86 Hulumtimi dhe inovacioni	Article 86 Research and innovation	Član 86 Istraživanje i inovacije
1. Agjencia ndihmon Komisionin dhe shtetet anëtare në identifikimin e temave kyçe të hulumtimit në fushën e aviacionit civil për të kontribuar në sigurimin e konsistencës dhe koordinimit ndërmjet hulumtimit dhe zhvillimit me financim publik dhe politikave që bien brenda fushëveprimit të kësaj Rregulloreje.	1. The Agency shall assist the Commission and the Member States in identifying key research themes in the field of civil aviation to contribute to ensuring consistency and coordination between publicly funded research and development and policies falling within the scope of this Regulation.	1. Agencija pomaže Komisiji i državama članicama u utvrđivanju ključnih tema istraživanja u području civilnog vazduhoplovstva kako bi doprinela osiguravanju usklađenosti i koordinacije između javno finansiranih aktivnosti istraživanja i razvoja i politika iz područja primene ove Uredbe.
2. Agjencia mbështet Komisionin në përcaktimin dhe përmbushjen e programeve relevante kornizë të Unionit për aktivitetet e hulumtimit dhe inovacionit dhe të programeve vjetore dhe shumëvjeçare të punës, duke përfshirë edhe në kryerjen e procedurave të vlerësimit, në shqyrtimin e projekteve të financuara dhe në shfrytëzimin e rezultateve të projekteve të hulumtimit dhe inovacionit.	2. The Agency shall support the Commission in the definition and accomplishment of the relevant Union framework programmes for research and innovation activities and of the annual and multi-annual work programmes, including in the conduct of evaluation procedures, in the review of funded projects and in the exploitation of the results of research and innovation projects.	2. Agencija pruža podršku Komisiji u utvrđivanju i realizaciji odgovarajućih okvirnih programa Unije za aktivnosti istraživanja i inovacija i godišnjih i višegodišnjih programa rada, uključujući podršku u sprovođenju postupaka evaluacije, reviziji finansiranih projekata i upotrebi rezultata istraživačkih i inovacionih projekata.
Agjencia zbaton pjesët e ndërlidhura me aviacionin civil të Programit Kornizë për Hulumtim dhe Inovacion, kur Komisioni ka deleguar kompetencat përkatëse tek ajo.	The Agency shall implement civil aviation related parts of the Framework Programme for Research and Innovation where the Commission has delegated the relevant powers to it.	Agencija sprovodi delove Okvirnog programa Unije za istraživanje i inovacije povezane sa civilnim vazduhoplovstvom ako joj je Komisija prenela relevantna ovlašćenja.
3. Agjencia mund të zhvillojë dhe financojë hulumtime për aq sa këto janë të lidhura ngushtë me përmirësimin e aktiviteteve në fushën e saj të kompetencës. Nevojat dhe aktivitetet e Agjencisë lidhur me hulumtim përfshihen në programin e saj vjetor të punës.	3. The Agency may develop and finance research in so far as is strictly related to the improvement of activities in its field of competence. The Agency's research needs and activities shall be included in its annual work programme.	3. Agencija može razvijati i finansirati istraživanja ako se ona izričito odnose na poboljšanje aktivnosti iz područja njene nadležnosti. Istraživačke potrebe i aktivnosti Agencije navode se u njenom godišnjem programu rada.
4. Rezultatet e hulumtimeve të financuara nga Agjencia publikohen, përveç nëse rregullat e	4. The results of research funded by the Agency shall be published, unless the applicable rules of	4. Rezultati istraživanja koje finansira Agencija objavljuju se, osim ako je takvo objavljivanje

zbatueshme të së drejtës së pronësisë intelektuale ose rregullat e sigurisë të Agjencisë të përmendura në nenin 123 përjashtojnë një publikim të tillë.	intellectual property law or the security rules of the Agency referred to in Article 123 preclude such publication.	zabranjeno primenjivim pravilima iz područja prava intelektualnog vlasništva ili bezbednosnim pravilima Agencije iz člana 123.
5. Përveç detyrave të përcaktuara në paragrafët 1 deri 4 të këtij neni dhe në nenin 75, Agjencia mund të angazhohet edhe në aktivitete hulumtuese ad hoc, me kusht që këto aktivitete janë në përputhje me detyrat e Agjencisë dhe objektivat e kësaj Rregulloreje.	5. In addition to the tasks set out in paragraphs 1 to 4 of this Article and in Article 75, the Agency may also engage in ad hoc research activities, provided that those activities are compatible with the Agency's tasks and the objectives of this Regulation.	5. Uz zadatke utvrđene u stavovima od 1. do 4. ovog člana i u članu 75. Agencija se može baviti i ad hoc istraživačkim aktivnostima ako su te aktivnosti u skladu sa zadacima Agencije i ciljevima ove Uredbe.
Neni 87 **Mbrojtja e mjedisit**	**Article 87** **Environmental protection**	**Član 87** **Zaštita životne sredine**
1. Masat e marra nga Agjencia në lidhje me emetimet dhe zhurmën, me qëllim të certifikimit të dizajnit të produkteve në përputhje me nenin 11, synojë të parandalojnë efektet e konsiderueshme të dëmshme në klimën, mjedisin dhe shëndetin e njeriut të shkaktuara nga produktet përkatëse të aviacionit civil, duke i kushtuar vëmendje të duhur standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të rekomanduara, përfitimeve mjedisore, fizibilitetit teknologjik dhe ndikimit ekonomik.	1. The measures taken by the Agency as regards emissions and noise, for the purpose of the certification of the design of products in accordance with Article 11, shall aim to prevent significant harmful effects on climate, environment and human health caused by the civil aviation products concerned, giving due consideration to the inter- national standards and recommended practices, environmental benefits, technological feasibility and economic impact.	1. Merama koje Agencija preduzima u pogledu emisija i buke u svrhu sertifikacije projekata proizvoda u skladu sa članom 11. nastoje se sprečiti značajni štetni uticaji na klimu, životnu sredinu i ljudsko zdravlje koje uzrokuju dotični proizvodi civilnog vazduhoplovstva, uzimajući u obzir međunarodne standarde i preporučene prakse, koristi za životnu sredinu, tehnološku izvodljivost i ekonomske posledice.
2. Komisioni, Agjencia, institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë tjera të Unionit dhe shtetet anëtare, brenda fushave të tyre përkatëse të kompetencës, bashkëpunojnë në çështjet mjedisore, duke përfshirë ato të adresuara në Direktivën për krijimin e një skeme për tregtimin e lejimeve (kuotave) të emetimeve të gazrave serrë brenda Komunitetit dhe Rregulloren në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe	2. The Commission, the Agency, other Union institutions, bodies, offices and agencies and the Member States shall, within their respective fields of competence, cooperate on environmental matters, including those addressed in Directive establishing a scheme for greenhouse gas emission allowance trading within the Community and Regulation concerning the Registration, Evaluation,	2. Komisija, Agencija, druge institucije, tela, kancelarije i agencije Unije i države članice sarađuju, u svojim područjima nadležnosti, na pitanjima zaštite životne sredine, uključujući ona navedena u Direktivi o uspostavljanju sistema trgovanja emisionim jedinicama gasova sa efektom staklene bašte unutar Zajednice i Uredbi o registraciji, evaluaciji, autorizaciji i ograničenjima hemikalija (REACH), kako bi se

Kufizimin e Kimikateve (REACH), me qëllim që të sigurohet se merren parasysh ndërvarësitë mes domenit të klimës dhe mbrojtjes së mjedisit, shëndetit të njeriut dhe domeneve të tjera teknike të aviacionit civil, duke i kushtuar vëmendje të duhur standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të rekomanduara, përfitimeve mjedisore, fizibilitetit teknologjik dhe ndikimit ekonomik.	Authorisation and Restriction of Chemicals (REACH), with a view to ensuring that interdependencies between climate and environmental protection, human health and other, technical, domains of civil aviation are taken into account, giving due consideration to the international standards and recommended practices, environmental benefits, technological feasibility and economic impact.	osiguralo da se u obzir uzme međuzavisnost područja klime i zaštite životne sredine, ljudskog zdravlja i drugih tehničkih područja civilnog vazduhoplovstva, uzimajući u obzir međunarodne standarde i preporučene prakse, koristi za životnu sredinu, tehnološku izvodljivost i ekonomske posledice.
3. Agjencia, kur posedon ekspertizën përkatëse, ndihmon Komisionin në përcaktimin dhe koordinimin e politikave dhe veprimeve të aviacionit civil në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, në veçanti duke kryer studime, simulime dhe duke ofruar këshilla teknike, duke marrë parasysh ndërvarësitë ndërmjet domenit të klimës dhe mbrojtjes së mjedisit, shëndetit të njeriut dhe domeneve tjera teknike të aviacionit civil.	3. The Agency shall, where it has the relevant expertise, assist the Commission with the definition and coordination of civil aviation environmental protection policies and actions, in particular by conducting studies, simulations and providing technical advice while taking into account the interdependencies between climate and environmental protection, human health and other, technical, domains of civil aviation.	3. Ako ima relevantno stručno znanje, Agencija pomaže Komisiji u definisanju i koordinaciji politika i mera civilnog vazduhoplovstva povezanih sa životnom sredinom, posebno sprovođenjem studija, simulacija i pružanjem tehničkih saveta uzimajući u obzir međuzavisnost područja klime i zaštite životne sredine, ljudskog zdravlja i drugih tehničkih područja civilnog vazduhoplovstva.
4. Për të informuar palët e interesuara dhe publikun e gjerë, Agjencia, së paku çdo tre vjet, publikon një rishikim mjedisor, i cili ofron një përshkrim objektiv të gjendjes së mbrojtjes së mjedisit në lidhje me aviacionin civil në Union.	4. In order to inform interested parties and the general public, the Agency shall, at least every three years, publish an environmental review, which shall give an objective account of the state of environmental protection relating to civil aviation in the Union.	4. Kako bi obavestila zainteresovane strane i javnost, Agencija najmanje svake tri godine objavljuje izveštaj o uticaju na životnu sredinu u kojem se daje objektivna procena stanja zaštite životne sredine s obzirom na civilno vazduhoplovstvo u Uniji.
Gjatë përgatitjes së këtij rishikimi, Agjencia mbështetet kryesisht në informacionet e institucioneve dhe organeve të Unionit që veçse janë në dispozicion, si dhe në informacionet në dispozicion të publikut.	When preparing that review, the Agency shall primarily rely on information already available to Union institutions and bodies, as well as on publicly available information.	Prilikom pripreme tog izveštaja Agencija se prvenstveno oslanja na informacije koje su već dostupne institucijama i telima Unije, kao i na javno dostupne informacije.

Agjencia përfshin shtetet anëtare dhe konsultohet me akterët dhe organizatat përkatëse në hartimin e këtij rishikimi.	The Agency shall associate the Member States and consult relevant stakeholders and organisations in the development of that review.	Agencija u izradu tog izveštaja uključuje države članice i savetuje se sa relevantnim zainteresovanim stranama i organizacijama.
Ky rishikim gjithashtu përmban rekomandimet që synojnë të përmirësojnë nivelin e mbrojtjes së mjedisit në fushën e aviacionit civil në Union.	That review shall also contain recommendations aiming to improve the level of environmental protection in the area of civil aviation in the Union.	Taj izveštaj sadrži i preporuke usmerene na poboljšanje nivoa zaštite životne sredine u području civilnog vazduhoplovstva u Uniji.
Neni 88 **Ndërvarësitë ndërmjet mbrojtjes dhe sigurisë së aviacionit civil**	**Article 88** **Interdependencies between civil aviation safety and security**	**Član 88** **Međuzavisnost bezbednosti i zaštite civilnog vazduhoplovstva**
1. Komisioni, Agjencia dhe shtetet anëtare bashkëpunojnë në çështjet e sigurisë që lidhen me aviacionin civil, duke përfshirë sigurinë kibernetike, kur ekzistojnë ndërvarësi ndërmjet mbrojtjes dhe sigurisë së aviacionit civil.	1. The Commission, the Agency and the Member States shall cooperate on security matters related to civil aviation, including cyber security, where interdependencies between civil aviation safety and security exist.	1. Komisija, Agencija i države članice sarađuju u pitanjima zaštite povezanim sa civilnim vazduhoplovstvom, uključujući sajber bezbednost, ako postoji međuzavisnost bezbednosti i zaštite civilnog vazdušnog saobraćaja.
2. Kur ekzistojnë ndërvarësitë ndërmjet mbrojtjes dhe sigurisë së aviacionit civil, Agjencia, në bazë të kërkesës, ofron asistencë teknike për Komisionin, kur Agjencia ka ekspertizën përkatëse të mbrojtjes, në zbatimin e Rregullores (MPB) 01/2009 për rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil.	2. Where interdependencies between civil aviation safety and security exist, the Agency shall, upon request, provide technical assistance to the Commission, where the Agency has the relevant safety expertise, in the implementation of Regulation 01/2009 on common rules in the field of civil aviation security.	2. Ako postoji međuzavisnost bezbednosti i zaštite civilnog vazduhoplovstva, Agencija na zahtev, ako ima relevantno stručno znanje u području zaštite, pruža tehničku pomoć Komisiji u sprovođenju Uredbu (MUP) Br 01/2009- o zajedničkim pravilima u oblasti bezbednosti civilnog vazduhoplovstva
3. Për të kontribuar në mbrojtjen e aviacionit civil kundër veprimeve të ndërhyrjes së paligjshme ku ekzistojnë ndërvarësi ndërmjet mbrojtjes dhe sigurisë së aviacionit civil, Agjencia, kur është e nevojshme, reagon pa vonesë për një problem urgjent që është i një rëndësie të përbashkët për shtetet anëtare dhe që bie në kuadër të kësaj Rregulloreje duke:	3. To contribute to protecting civil aviation against acts of unlawful interference where interdependencies between civil aviation safety and security exist, the Agency shall where necessary, react without undue delay to an urgent problem which is of common concern to Member States and which falls within the scope of this Regulation by:	3. Radi pružanja doprinosa zaštiti civilnog vazduhoplovstva od dela nezakonitog ometanja i ako postoji međuzavisnost bezbednosti i zaštite civilnog vazdušnog saobraćaja, Agencija, prema potrebi, bez odlaganja reaguje na hitan problem koji je od zajedničkog interesa za države članice i koji je obuhvaćen područjem primene ove Uredbe:

(a) ndërmarrë masat nga pika (h) e nenit 77 (1) për të adresuar dobësitë në dizajnin e avionëve;	(a) taking measures under point (h) of Article 77(1) to address vulnerabilities in aircraft design;	(a) preduzimanjem mera u skladu sa članom 77. stavom 1. tačkom (h) radi ispravljanja nedostataka u projektu vazduhoplova;
(b) rekomanduar veprime korrigjuese që duhen ndërmarrë nga autoritetet kombëtare kompetente ose personat fizik dhe juridik që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje dhe/ose duke u shpërndarë informacione përkatëse këtyre autoriteteve dhe personave, në rast se problemi ndikon në operimin e avionëve, duke përfshirë rreziqet për aviacionin civil që rrjedhin nga zonat e konfliktit.	(b) recommending corrective actions to be taken by the national competent authorities or natural and legal persons subject to this Regulation and/or disseminating relevant information to those authorities and persons, in the case that the problem affects aircraft operation, including the risks to civil aviation arising from conflict zones.	(b) preporučivanjem korektivnih mera koje moraju preduzeti nadležna nacionalna tela ili fizička i pravna lica koja podležu ovoj Uredbi i/ili dostavljanjem odgovarajućih informacija tim telima i osobama, u slučaju da problem utiče na operacije vazduhoplova, uključujući rizike koji za civilno vazduhoplovstvo predstavljaju zone sukoba.
Para se të ndërmerren masat e përmendura në pikat (a) dhe (b) të nënparagrafit të parë, Agjencia merr pëlqimin e Komisionit dhe konsultohet me shtetet anëtare. Agjencia i bazon këto masa, kur është e mundur, në vlerësimet e përbashkëta të rreziqeve të Unionit dhe merr parasysh nevojën për reagim të shpejtë në rastet emergjente.	Before taking the measures referred to in points (a) and (b) of the first subparagraph, the Agency shall obtain the agreement of the Commission and consult the Member States. The Agency shall base those measures, where possible, on common Union risk assessments and take into account the need for rapid reaction in emergency cases.	Pre preduzimanja mera iz prvog podstava tačaka (a) i (b) Agencija pribavlja saglasnost Komisije i savetuje se sa državama članicama. Agencija te mere zasniva, ako je to moguće, na zajedničkim procenama rizika Unije i uzima u obzir potrebu za brzom reakcijom u hitnim slučajevima.
Neni 89 **Ndërvarësitë ndërmjet sigurisë së aviacionit civil dhe faktorëve socioekonomikë**	**Article 89** **Interdependencies between civil aviation safety and socioeconomic factors**	**Član 89** **Međuzavisnost zaštite civilnog vazduhoplovstva i socioekonomskih faktora**
1. Komisioni, Agjencia, institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë tjera të Unionit dhe shtetet anëtare, brenda fushave të tyre përkatëse të kompetencës, bashkëpunojnë me synimin për të siguruar që ndërvarësitë ndërmjet sigurisë së aviacionit civil dhe faktorëve të lidhur socioekonomikë të merren parasysh, duke përfshirë edhe në procedurat rregullatore, mbikëqyrjen dhe	1. The Commission, the Agency, other Union institutions bodies, offices and agencies and the Member States, shall, within their respective fields of competence, cooperate with a view to ensuring that interdependencies between civil aviation safety and related socioeconomic factors are taken into account including in regulatory procedures, oversight and	1. Komisija, Agencija, druge institucije, tela, kancelarije i agencije Unije i države članice sarađuju, u svojim područjima nadležnosti, kako bi se osiguralo da se međuzavisnost zaštite civilnog vazduhoplovstva i socioekonomskih faktora uzme u obzir i u regulatornim postupcima, nadzoru i sprovođenju kulture pravičnosti kako je definisana u članu 2. Uredbe

zbatimin e kulturës së drejtë siç përcaktohet në nenin 2 të Rregullores Nr. 9/2017 të AAC-së, për të adresuar rreziqet socioekonomike për sigurinë e aviacionit. 2. Agjencia konsultohet me akterët relevantë gjatë adresimit të ndërvarësive të tilla. 3. Agjencia, çdo tre vjet, publikon një rishikim që ofron një përshkrim objektiv të veprimeve dhe masave të ndërmarra, në veçanti të atyre që adresojnë ndërvarësitë ndërmjet sigurisë së aviacionit civil dhe faktorëve socioekonomikë.	implementation of just culture as defined in Article 2 of CAA Regulation No 9/2017, to address socioeconomic risks to aviation safety. 2. The Agency shall consult relevant stakeholders when addressing such interdependencies. 3. The Agency shall, every three years, publish a review, which shall give an objective account of the actions and measures undertaken, in particular those addressing the interdependencies between civil aviation safety and socio- economic factors.	ACV-a br. 9/2017, kako bi se uklonili socioekonomski rizici za zaštitu civilnog vazduhoplovstva. 2. Kada se bavi pitanjem takve međuzavisnosti Agencija se savetuje sa relevantnim zainteresovanim stranama. 3. Agencija svake tri godine objavljuje izveštaj u kojem se iznosi objektivna ocena preduzetih delovanja i mera, posebno onih koji se odnose na međuzavisnost zaštite civilnog vazduhoplovstva i socioekonomskih faktora.
Neni 90 **Bashkëpunimi ndërkombëtar**	**Article 90** **International cooperation**	**Član 90** **Međunarodna saradnja**
1. Agjencia, sipas kërkesës, ndihmon Komisionin në menaxhimin e marrëdhënieve me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Rregullore. Kjo ndihmë, në veçanti, kontribuon në harmonizimin e rregullave, njohjen reciproke të certifikatave, në interes të industrisë evropiane dhe në promovimin e standardeve evropiane të sigurisë së aviacionit. 2. Agjencia mund të bashkëpunojë me autoritetet kompetente të vendeve të treta dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente në çështjet e mbuluara nga kjo Rregullore. Për këtë qëllim, Agjencia, në konsultim paraprak me Komisionin, mund të vendosë aranzhime pune me këto autoritete dhe organizata ndërkombëtare. Këto marrëveshje	1. The Agency shall, upon request, assist the Commission in its management of relations with third countries and international organisations relating to matters covered by this Regulation. Such assistance shall in particular contribute to the harmonisation of rules, the mutual recognition of certificates, in the interest of European industry, and the promotion of European aviation safety standards. 2. The Agency may cooperate with the competent authorities of third countries and with international organisations competent in matters covered by this Regulation. To this end, the Agency, in prior consultation with the Commission, may establish working arrangements with those authorities and international organisations. Those working	1. Agencija, na zahtev, pomaže Komisiji u upravljanju njenim odnosima sa trećim zemljama i međunarodnim organizacijama u vezi sa pitanjima obuhvaćenim ovom Uredbom. Takvom se pomoći posebno doprinosi usklađivanju pravila, uzajamnom priznavanju sertifikata u interesu evropske industrije i promovisanju evropskih standarda bezbednosti u vazduhoplovstvu. 2. Agencija može sarađivati sa nadležnim telima trećih zemalja i međunarodnim organizacijama koje su nadležne za pitanja obuhvaćena ovom Uredbom. U tu svrhu Agencija može, uz prethodno savetovanje sa Komisijom, uspostaviti radne aranžmane sa tim telima i međunarodnim organizacijama. Tim radnim

pune nuk krijojnë detyrime ligjore për Unionin dhe shtetet anëtare të tij.	arrangements shall not create legal obligations incumbent on the Union and its Member States.	aranžmanima ne nastaju pravne obaveze za Uniju i njene države članice.
3. Agjencia ndihmon shtetet anëtare në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Rregullore, në veçanti të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas Konventës së Çikagos.	3. The Agency shall assist Member States in exercising their rights and fulfilling their obligations under international agreements relating to matters covered by this Regulation, in particular their rights and obligations under the Chicago Convention.	3. Agencija pomaže državama članicama u ostvarivanju njihovih prava i ispunjavanju njihovih obaveza na osnovu međunarodnih sporazuma povezanih sa pitanjima obuhvaćenim ovom Uredbom, posebno njihovih prava i obaveza iz Čikaške konvencije.
Agjencia mund të veprojë si Organizatë Rajonale e Mbikëqyrjes së Sigurisë në kuadër të ICAO.	The Agency may act as a Regional Safety Oversight Organisation in the ICAO framework.	Agencija može delovati kao regionalna organizacija za nadzor bezbednosti u okviru ICAO-a.
4. Agjencia, në bashkëpunim me Komisionin dhe shtetet anëtare, përfshin dhe përditëson, aty ku është e nevojshme, informacionin e mëposhtëm në repozitorin e referuar në nenin 74:	4. The Agency shall, in cooperation with the Commission and the Member States, include and update where necessary, the following information in the repository referred to in Article 74:	4. Agencija u saradnji sa Komisijom i državama članicama uključuje sledeće informacije u bazu podataka iz člana 74. te ih, prema potrebi, ažurira:
(a) informacioni mbi përputhjen e kësaj Rregulloreje dhe të akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj dhe të masave të marra nga Agjencia sipas kësaj Rregulloreje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara;	(a) information on the compliance of this Regulation and of the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof and of the measures taken by the Agency under this Regulation with the international standards and recommended practices;	(a) informacije o usklađenosti ove Uredbe i delegiranih i sprovedbenih akata donesenih na osnovu ove Uredbe i mera koje Agencija preduzima u skladu sa ovom Uredbom sa međunarodnim standardima i preporučenim praksama;
(b) informacione tjera në lidhje me zbatimin e kësaj Rregulloreje, që janë të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare dhe që janë relevante për monitorimin nga ICAO të përputhshmërisë së shteteve anëtare me Konventën e Çikagos dhe standardet ndërkombëtare dhe praktikat e rekomanduara.	(b) other information related to the implementation of this Regulation, which is common to all Member States and which is relevant for monitoring by ICAO of the compliance of Member States with the Chicago Convention and international standards and recommended practices.	(b) druge informacije u vezi sa sprovođenjem ove Uredbe koje su zajedničke svim državama članicama i relevantne za nadzor koji sprovodi ICAO u pogledu usklađenosti država članica sa Čikaškom konvencijom i međunarodnim standardima i preporučenim praksama.

Shtetet anëtare përdorin këto informacione kur zbatojnë detyrimet e tyre sipas nenit 38 të Konventës së Çikagos dhe kur ofrojnë informacione për ICAO-në nën Programin Universal të Auditimit të Sigurisë të ICAO-s.	The Member States shall use that information when implementing their obligations under Article 38 of the Chicago Convention and when providing to ICAO information under the ICAO Universal Safety Oversight Audit Programme.	Države članice upotrebljavaju navedene informacije pri sprovođenju svojih obaveza na osnovu člana 38. Čikaške konvencije i pri dostavi informacija ICAO-u u okviru ICAO-ovog Jedinstvenog programa nadzora bezbednosti.
5. Pa cenuar dispozitat përkatëse të traktatit, Komisioni, Agjencia dhe autoritetet kombëtare kompetente që janë të përfshira në aktivitetet e ICAO-s bashkëpunojnë, nëpërmjet një rrjeti ekspertësh, për çështjet teknike që bien në kuadër të fushëveprimit të kësaj Rregulloreje dhe që lidhen me punën e ICAO-s. Agjencia i ofron këtij rrjeti mbështetjen e nevojshme administrative, duke përfshirë ndihmën për përgatitjen dhe organizimin e mbledhjeve të tij.	5. Without prejudice to the relevant Treaty provisions, the Commission, the Agency and the national competent authorities who are involved in ICAO activities shall collaborate, through a network of experts, on technical matters falling within the scope of this Regulation and related to the work of ICAO. The Agency shall provide this network with the necessary administrative support, including assistance for the preparation and organisation of its meetings.	5. Ne dovodeći u pitanje odgovarajuće odredbe Ugovora Komisija, Agencija i nacionalna nadležna tela koja učestvuju u aktivnostima ICAO-a sarađuju, putem mreže stručnjaka, na tehničkim pitanjima koja ulaze u područje primene ove Uredbe i povezana su sa radom ICAO-a. Agencija toj mreži osigurava potrebnu administrativnu podršku, uključujući pomoć u pripremi i organizaciji njenih sastanaka.
6. Përveç detyrave të përcaktuara në paragrafët 1 deri 5 të këtij neni dhe në nenin 75, Agjencia gjithashtu mund të angazhohet në bashkëpunim teknik ad hoc dhe projekte të hulumtimit dhe ndihmës me vende të treta dhe organizata ndërkombëtare, me kusht që këto aktivitete janë në përputhje me detyrat e Agjencisë dhe objektivat e përcaktuara në nenin 1.	6. In addition to the tasks set out in paragraphs 1 to 5 of this Article and in Article 75, the Agency may also engage in ad hoc technical cooperation, and research and assistance projects with third countries and international organisations, provided that those activities are compatible with the Agency's tasks and the objectives set out in Article 1.	6. Uz zadatke utvrđene u stavovima od 1. do 5. ovog člana i člana 75. Agencija takođe može sa trećim zemljama i međunarodnim organizacijama učestvovati u ad hoc tehničkoj saradnji i projektima istraživanja i pomoći, ako su te aktivnosti u skladu sa zadacima Agencije i ciljevima utvrđenim u članu 1.
Neni 91 **Menaxhimi i Krizave të Aviacionit**	**Article 91** **Aviation Crisis Management**	**Član 91** **Upravljanje kriznim situacijama u vazduhoplovstvu**
1. Agjencia, brenda fushës së saj të kompetencës, kontribuon në reagimin me kohë dhe	1. The Agency shall, within its field of competence, contribute to a timely response to and mitigation of aviation crises, in	1. Agencija, u području svoje nadležnosti, doprinosi pravovremenom odgovoru na krizne

në zbutjen e krizave të aviacionit, në koordinim me akterë tjerë të përshtatshëm.	coordination, with other appropriate stakeholders.	situacije u vazduhoplovstvu i njihovom ublažavanju, u koordinaciji sa drugim odgovarajućim zainteresovanim stranama.
2. Agjencia merr pjesë në Celulën Evropiane për Koordinimin e Krizave të Aviacionit ('EACCC'), të themeluar në përputhje me Nenin 18 të Rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e funksioneve të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror (ATM).	2. The Agency shall participate in the European Aviation Crisis Coordination Cell ('EACCC') established in accordance with Article 18 of Regulation laying down detailed rules for the implementation of air traffic management (ATM) network functions.	2. Agencija učestvuje u Evropskoj jedinici za koordinaciju kriznih situacija u vazdušnom saobraćaju („EACCC"), uspostavljenoj u skladu sa članom 18. Uredbe koja utvrđuje detaljna pravila za sprovođenje funkcija mreže za upravljanje vazdušnim saobraćajem (ATM).
Neni 92 **Trajnimi në fushën e aviacionit**	**Article 92** **Aviation training**	**Član 92** **Osposobljavanje u području vazduhoplovstva**
1. Me qëllim të promovimit të praktikave më të mira dhe uniformitetit në zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe të akteve të deleguara dhe zbatuese të miratuara në bazë të saj, Agjencia, sipas kërkesës së ofruesit të trajnimit të aviacionit, mund të vlerësojë përputhshmërinë e ofruesit dhe kurseve të tij të trajnimit me kërkesat e përcaktuara nga Agjencia dhe të publikuara në publikimin e saj zyrtar. Pas përcaktimit të pajtueshmërisë së tillë, ofruesi ka të drejtë të ofrojë kurse trajnimi të miratuara nga Agjencia.	1. In order to promote best practices and uniformity in the implementation of this Regulation and of the delegated and implementing acts adopted on the basis thereof, the Agency may, upon request by a provider of aviation training, assess the compliance of that provider and of its training courses with the requirements established by the Agency and published in its official publication. Upon having established such compliance, the provider shall be entitled to provide Agency-approved training courses.	1. U svrhu podsticanja najbolje prakse i ujednačenosti u sprovođenju ove Uredbe i delegiranih i sprovedbenih akata donesenih na osnovu ove Uredbe, Agencija može na zahtev pružalaca osposobljavanja u području vazduhoplovstva proceniti usklađenost tog pružaoca osposobljavanja i njegovih kurseva osposobljavanja sa zahtevima koje je Agencija utvrdila i objavila u svom službenom listu. Nakon što se utvrdi takva usklađenost, pružalac ima pravo pružati kurseve osposobljavanja koje je odobrila Agencija.
2. Agjencia mund të ofrojë trajnim kryesisht të paraparë për stafin e saj dhe stafin e autoriteteve kombëtare kompetente, por edhe për autoritetet kompetente të vendeve të treta, organizatat ndërkombëtare, personat fizikë dhe juridikë që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje dhe palët tjera të interesuara, qoftë nëpërmjet burimeve të veta të	2. The Agency may provide training primarily addressed to its and national competent authorities' staff, but also to competent authorities of third countries, international organisations, the natural and legal persons subject to this Regulation and other interested parties, either through its own training	2. Agencija može pružati osposobljavanje prvenstveno namenjeno njenom osoblju i osoblju nacionalnih nadležnih tela, ali i nadležnim telima trećih zemalja, međunarodnim organizacijama, fizičkim i pravnim licima koja podležu ovoj Uredbi i drugim zainteresovanim stranama, bilo služeći se vlastitim resursima za osposobljavanje ili,

trajnimit ose, kur është e nevojshme, duke u mbështetur në ofruesit e jashtëm të trajnimit.	resources or, where necessary, by relying on external training providers.	prema potrebi, oslanjajući se na eksterne pružaoce osposobljavanja.
Neni 93 **Zbatimi i Qiellit të Vetëm Evropian**	**Article 93** **Implementation of Single European Sky**	**Član 93** **Sprovođenje jedinstvenog evropskog neba**
Agjencia, kur posedon ekspertizën përkatëse dhe sipas kërkesës, ofron asistencë teknike për Komisionin, në zbatimin e Qiellit të Vetëm Evropian, në veçanti duke:	The Agency shall, where it has the relevant expertise and upon request, provide technical assistance to the Commission, in the implementation of the Single European Sky, in particular by:	Agencija, ako ima relevantno stručno znanje te na zahtev, pruža tehničku pomoć Komisiji u sprovođenju jedinstvenog evropskog neba, posebno:
(a) kryer inspektime teknike, hetime teknike, dhe studime;	(a) conducting technical inspections, technical investigations, and studies;	(a) sprovođenjem tehničkih inspekcijskih pregleda, tehničkih istraga i studija;
(b) kontribuar në çështjet e mbuluara nga kjo Rregullore, në bashkëpunim me Organin Shqyrtues të Performancës të paraparë në nenin 11 të Rregullores Nr. 8/2009 të AAC-së, për zbatimin e skemës së performancës për shërbimet e navigimit ajror dhe funksionet e rrjetit;	(b) contributing, in matters covered by this Regulation, in cooperation with the Performance Review Body provided for in Article 11 of CAA Regulation No 8/2009, to the implementation of a performance scheme for air navigation services and network functions;	(b) pružanjem doprinosa sprovođenju šeme performansi za usluge u vazdušnoj navigaciji i mrežne funkcije u pitanjima obuhvaćenim ovom Uredbom, u saradnji sa telom za reviziju performanse predviđenim u članu 11 Uredbe ACV-a br. 8/2009;
(c) kontribuar në zbatimin e Master Planit të MTA-së, përfshirë edhe zhvillimin dhe vendosjen e programit SESAR.	(c) contributing to the implementation of the ATM Master Plan, including the development and deployment of the SESAR programme.	(c) pružanjem doprinosa sprovođenju glavnog plana ATM-a, između ostalog razvoju i uvođenju programa SESAR.

SEKSIONI II	SECTION II	ODELJAK II
Struktura e brendshme	**Internal structure**	**Interna struktura**
Neni 94 **Statusi ligjor, selia dhe zyrat lokale**	**Article 94** **Legal status, seat and local offices**	**Član 94** **Pravni status, sedište i lokalne kancelarije**
1. Agjencia është një organ i Unionit. Ajo ka personalitet juridik.	1. The Agency shall be a body of the Union. It shall have legal personality.	1. Agencija je telo Unije. Ima pravnu sposobnost.
2. Në secilin nga shtetet anëtare, Agjencia gëzon kapacitetin më të gjerë ligjor të akorduar personave juridikë sipas ligjeve të tyre. Ajo, në veçanti, mund të marrë ose tjetërsojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe mund të jetë palë në procedurat ligjore.	2. In each of the Member States, the Agency shall enjoy the most extensive legal capacity accorded to legal persons under their laws. It may, in particular, acquire or dispose of movable and immovable property and may be a party to legal proceedings.	2. U svakoj državi članici Agencija ima najširu pravnu sposobnost koja se prema nacionalnim propisima dodeljuje pravnim licima. Agencija posebno može sticati i otuđivati pokretnu i nepokretnu imovinu te može biti strana u sudskim postupcima.
3. Selia e Agjencisë është në Cologne, Republika Federale e Gjermanisë.	3. The seat of the Agency shall be Cologne, Federal Republic of Germany.	3. Sedište Agencije je u Kelnu, u Saveznoj Republici Nemačkoj.
4. Agjencia mund të hap zyra lokale në shtetet anëtare ose të bashkëstacionoj stafin në delegacionet e Unionit në vendet e treta, në përputhje me nenin 104(4).	4. The Agency may establish local offices in the Member States or co-locate staff in Union delegations in third countries, in accordance with Article 104(4).	4. Agencija može osnivati lokalne kancelarije u državama članicama ili svoje osoblje smestiti u delegacije Unije u trećim zemljama, u skladu sa članom 104. stavom 4.
5. Agjencia përfaqësohet ligjërisht nga Drejtori i saj Ekzekutiv.	5. The Agency shall be legally represented by its Executive Director.	5. Agenciju pravno zastupa njen izvršni direktor.
Neni 95 **Stafi**	**Article 95** **Staff**	**Član 95** **Osoblje**
1. Rregulloret e stafit të zyrtarëve të Bashkimit Evropian, kushtet e punësimit të nëpunësve tjerë të	1. The Staff Regulations of Officials of the European Union, the Conditions of	1. Na osoblje koje zapošljava Agencija primenjuju se Pravilnik o osoblju Evropske

Bashkimit Evropian dhe rregullat e miratuara me marrëveshje ndërmjet institucioneve të Unionit për zbatimin e këtyre rregulloreve të stafit dhe kushteve të punësimit zbatohen për stafin e punësuar nga Agjencia.	Employment of Other Servants of the European Union and the rules adopted by agreement between the institutions of the Union for giving effect to those Staff Regulations and Conditions of Employment shall apply to the staff employed by the Agency.	unije, Uslovi zaposlenja ostalih službenika Evropske unije i pravila donesena sporazumom između institucija Unije radi sprovođenja navedenog Pravilnika o osoblju i Uslova zaposlenja.
2. Agjencia mund të përdorë ekspertë kombëtarë të transferuar përkohësisht ose staf tjetër që nuk është i punësuar nga Agjencia. Bordi Menaxhues miraton një vendim që përcakton rregullat për transferin e përkohshëm të ekspertëve kombëtarë në Agjenci.	2. The Agency may make use of seconded national experts or other staff not employed by the Agency. The Management Board shall adopt a decision laying down rules on the secondment of national experts to the Agency.	2. Agencija se može koristiti upućenim nacionalnim stručnjacima i drugim osobljem koje nije zaposleno u Agenciji. Upravni odbor donosi odluku kojom utvrđuje pravila o upućivanju nacionalnih stručnjaka u Agenciju.
Neni 96 **Privilegjet dhe imunitetet**	**Article 96** **Privileges and immunities**	**Član 96** **Povlastice i imuniteti**
Protokolli Nr. 7 mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Bashkimit Evropian, i bashkangjitur në TEU dhe TFEU, zbatohet për Agjencinë dhe stafin e saj.	The Protocol No 7 on the Privileges and Immunities of the European Union, annexed to the TEU and to the TFEU, shall apply to the Agency and its staff.	Na Agenciju i njeno osoblje primenjuje se Protokol br. 7 o povlasticama i imunitetima Evropske unije, priložen UEU- u i UFEU-u.
Neni 97 **Përgjegjësia**	**Article 97** **Liability**	**Član 97** **Odgovornost**
1. Përgjegjësia kontraktuale e Agjencisë rregullohet nga ligji i zbatueshëm për kontratën në fjalë.	1. The contractual liability of the Agency shall be governed by the law applicable to the contract in question.	1. Ugovorna odgovornost Agencije uređena je pravom koje se primenjuje na dotični ugovor.
2. Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion për të dhënë vendim në bazë të çdo klauzole arbitrazhi të përfshirë në një kontratë të lidhur nga Agjencia.	2. The Court of Justice shall have jurisdiction to give judgment pursuant to any arbitration clause contained in a contract concluded by the Agency.	2. Sud je nadležan za donošenje presuda na osnovu bilo koje klauzule o arbitraži koja je sadržana u ugovoru koji je sklopila Agencija.

3. Në rastin e përgjegjësisë jokontraktuale, Agjencia, në përputhje me parimet e përgjithshme të përbashkëta për ligjet e shteteve anëtare, kompenson çdo dëm të shkaktuar nga ajo ose nga stafi i saj gjatë kryerjes së detyrave të tyre.	3. In the case of non-contractual liability, the Agency shall, in accordance with the general principles common to the laws of the Member States, make good any damage caused by it or by its staff in the performance of their duties.	3. U slučaju vanugovorne odgovornosti Agencija, u skladu sa opštim načelima koja su zajednička pravima država članica, nadoknađuje svaku štetu koju je prouzrokovala sama ili ju je prouzrokovalo njeno osoblje pri obavljanju svojih dužnosti.
4. Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion në mosmarrëveshjet mbi kompensimin e dëmeve të përmendura në paragrafin 3.	4. The Court of Justice shall have jurisdiction in disputes over compensation for damages referred to in paragraph 3.	4. Sud je nadležan u sporovima o naknadi štete iz stava 3.
5. Përgjegjësia personale e stafit të saj ndaj Agjencisë rregullohet nga dispozitat e përcaktuara në Rregulloret e Stafit ose Kushtet e Punësimit që zbatohen për ta.	5. The personal liability of its staff towards the Agency shall be governed by the provisions laid down in the Staff Regulations or Conditions of Employment applicable to them.	5. Lična odgovornost osoblja Agencije prema Agenciji uređena je odredbama koje su utvrđene u Pravilniku o osoblju ili u Uslovima zaposlenja koje se na njih primenjuju.
Neni 98 **Funksionet e Bordit Menaxhues**	**Article 98** **Functions of the Management Board**	**Član 98** **Funkcije Upravnog odbora**
1. Agjencia ka një Bord Menaxhues.	1. The Agency shall have a Management Board.	1. Agencija ima Upravni odbor.
2. Bordi Menaxhues:	2. The Management Board shall:	2. Upravni odbor:
(a) emëron Drejtorin Ekzekutiv, dhe aty ku është e mundur zgjat mandatin e tij/saj ose e largon nga detyra, në përputhje me nenin 103;	(a) appoint the Executive Director, and where relevant extend his or her term of office or remove him or her from office, in accordance with Article 103;	(a) imenuje izvršnog direktora i, prema potrebi, produžava njegov mandat ili ga razrešuje dužnosti u skladu sa članom 103;
(b) miraton një raport të konsoliduar vjetor mbi aktivitetet e Agjencisë dhe e dërgon atë deri më 1 korrik të çdo viti në Parlamentin Evropian, Këshillin, Komisionin dhe Gjykatën e Auditorëve. Raporti vjetor i konsoliduar i aktiviteteve bëhet publik;	(b) adopt a consolidated annual activity report on the Agency's activities and send it by 1 July each year to the European Parliament, the Council, the Commission and the Court of Auditors. The consolidated annual activity report shall be made public;	(b) donosi konsolidovan godišnji izveštaj o aktivnostima Agencije i šalje ga do 1. jula svake godine Evropskom parlamentu, Savetu, Komisiji i Revizorskom sudu. Konsolidovani godišnji izveštaj o radu objavljuje se;

(c) miraton çdo vit dokumentin e programimit të Agjencisë me shumicën e dy të tretave të anëtarëve me të drejtë vote dhe në përputhje me nenin 117;	(c) adopt each year the Agency's programming document by a majority of two-thirds of members entitled to vote and in accordance with Article 117;	(c) svake godine dvotrećinskom većinom glasova svojih članova s pravom glasa i u skladu sa članom 117. donosi programski dokument Agencije;
(d) miraton buxhetin vjetor të Agjencisë me shumicën e dy të tretave të anëtarëve me të drejtë vote dhe në përputhje me nenin 120(11);	(d) adopt the annual budget of the Agency by a majority of two-thirds of the members entitled to vote and in accordance with Article 120(11);	(d) dvotrećinskom većinom glasova svojih članova s pravom glasa i u skladu sa članom 120. stavom 11. donosi godišnji budžet Agencije;
(e) përcakton procedurat për marrjen e vendimeve nga Drejtori Ekzekutiv, siç referohen në nenet 115 dhe 116;	(e) establish procedures for making decisions by the Executive Director as referred to in Articles 115 and 116;	(e) utvrđuje postupke za donošenje odluka izvršnog direktora, kako je navedeno u članovima 115. i 116;
(f) kryen funksionet e tij në lidhje me buxhetin e Agjencisë në pajtim me nenet 120, 121 dhe 125;	(f) carry out its functions relating to the Agency's budget pursuant to Articles 120, 121 and 125;	(f) obavlja svoje funkcije u vezi sa budžetom Agencije na osnovu članova 120., 121. i 125;
(g) emëron anëtarët e Bordit të Apelit në pajtim me nenin 106;	(g) appoint the members of the Board of Appeal pursuant to Article 106;	(g) imenuje članove Žalbenog odbora na osnovu člana 106;
(h) ushtron autoritet disiplinor mbi Drejtorin Ekzekutiv;	(h) exercise disciplinary authority over the Executive Director;	(h) izvršava disciplinska ovlašćenja nad izvršnim direktorom;
(i) ofron opinionin e tij mbi rregullat që lidhen me tarifat dhe pagesat e përmendura në nenin 126;	(i) give its opinion on the rules relating to fees and charges referred to in Article 126;	(i) daje svoje mišljenje o pravilima koja se odnose na naknade i plaćanja iz člana 126;
(j) miraton Rregulloren e Punës;	(j) adopt its Rules of Procedure;	(j) donosi svoj poslovnik;
(k) vendosë mbi aranzhimet gjuhësore për Agjencinë;	(k) decide on the linguistic arrangements for the Agency;	(k) odlučuje o jezičkim aranžmanima u Agenciji;

(l) merr vendime për themelimin e strukturave të brendshme të Agjencisë në nivel të drejtorëve dhe, sipas nevojës, ndryshimet e tyre;	(l) take decisions on the establishment of the internal structures of the Agency at directors' level and, where necessary, their modifications;	(l) donosi odluke o uspostavljanju interne strukture Agencije na direktorskom nivou i, prema potrebi, njegovoj izmeni;
(m) në përputhje me paragrafin 6, ushtron, në lidhje me stafin e Agjencisë, kompetencat e dhëna nga Rregulloret e Stafit për Autoritetin Emërues dhe nga Kushtet e Punësimit të nëpunësve tjerë për autoritetin e autorizuar për të lidhur një kontratë pune ("kompetencat e autoritetit të emërimit");	(m) in accordance with paragraph 6, exercise, with respect to the staff of the Agency, the powers conferred by the Staff Regulations on the Appointing Authority and by the Conditions of Employment of Other Servants on the Authority Empowered to Conclude a Contract of Employment ('the appointing authority powers');	(m) u skladu sa stavom 6., u odnosu na osoblje Agencije izvršava ovlašćenja koja se Pravilnikom o osoblju dodeljuju telu za imenovanje i ovlašćenja koja se Uslovima zaposlenja ostalih službenika dodeljuju telu ovlašćenom za sklapanje ugovora o radu („ovlašćenja tela za imenovanja");
(n) miraton rregulla të përshtatshme zbatuese për zbatimin e Rregulloreve të Stafit dhe Kushteve të Punësimit të nëpunësve tjerë në përputhje me nenin 110 të Rregulloreve të Stafit;	(n) adopt appropriate implementing rules for giving effect to the Staff Regulations and the Conditions of Employment of Other Servants in accordance with Article 110 of the Staff Regulations;	(n) donosi odgovarajuća sprovedbena pravila za sprovođenje Pravilnika o osoblju i Uslova zaposlenja ostalih službenika u skladu sa članom 110. Pravilnika o osoblju;
(o) miraton rregulla për parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit në lidhje me anëtarët e saj, si dhe me anëtarët e Bordit të Apelit;	(o) adopt rules for the prevention and management of conflicts of interest in respect of its members, as well as of the members of the Board of Appeal;	(o) donosi pravila za sprečavanje sukoba interesa i upravljanje sukobima interesa svojih članova kao i članova Žalbenog odbora;
(p) siguron ndjekjen adekuate të gjetjeve dhe rekomandimeve që rrjedhin nga raportet dhe vlerësimet e auditimit të brendshëm ose të jashtëm, si dhe nga hetimet e Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit ('OLAF');	(p) ensure adequate follow-up to findings and recommendations stemming from the internal or external audit reports and evaluations, as well as from investigations of the European Anti-fraud Office ('OLAF');	(p) osigurava odgovarajuće naknadno postupanje s obzirom na nalaze i preporuke koji proizlaze iz izveštaja i evaluacija interne ili eksterne revizije i iz istraga Evropske Kancelarije za borbu protiv prevara („OLAF");
(q) miraton rregullat financiare të zbatueshme për Agjencinë në përputhje me nenin 125;	(q) adopt the financial rules applicable to the Agency in accordance with Article 125;	(q) donosi finansijska pravila koja se primenjuju na Agenciju u skladu sa članom 125;

